Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 6 • NUMRI 3 • 2009

SHPIRTI I SHTETIT TUAJ QËNDRON PËRBRENDA KËTYRE MUREVE TË BIBLIOTEKËS

Christopher W. Dell

Është kënaqësi të jesh në këto ngjarje por dua t'ju tregoj arsyen se përse personalisht është kënaqësi për mua të jem këtu. Para dhjetë vitesh ka qenë e pamundur ta vizitosh Bibliotekën Kombëtare. Nuk kishte muze të arkeologjisë, Muzeu Etnografik nuk funksiononte dhe për mua t'i shohësh këto ndryshime, të shohësh përparimin e bërë është kënaqësi personale.

Ruajtja e historisë dhe kulturës së një shteti janë iniciativa të vlefshme dhe thelbësore për të kultivuar krenarinë qytetare mes shtetasve. Njerëzit po ashtu kanë nevojë të kenë qasje në historinë, traditat dhe kulturën e tyre nëse dëshirojnë ta kuptojnë shoqërinë e tyre. Më e rëndësishme është në një demokraci multietnike si Kosova, ruajtja e historisë dhe kulturës, gjë qenësore për të kultivuar mirëkuptimin dhe tolerancën e përbashkët.

/ vijon në faqen 6 /

Fjalimi i Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë - Christopher W. Dell, në ceremoninë solemne të 65-Vjetorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

REZOLUTË NGA BIBLIOGRAFIA TE WEBOGRAFIA E LIBRIT SHQIP

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, si institucion kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri - Kosovë, mbajti më 23 - 24 nëntor 2009, edicionin e katërt të saj nën temën "Nga bibliografia te webografia e librit shqip".

Bazuar në gjendjen konkrete të bibliotekave dhe në problemet që u trajtuan, Konferenca miratoi rezolutën e mëposhtme:

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës i realizojnë detyrat e tyre funksionale duke mbajtur parasysh ngahera rolin e tyre përcaktues që ato kanë në hartimin dhe botimin e bibliografive kombëtare, sipas legjislacioneve përkatëse për bibliotekat në të dyja vendet, duke respektuar dhe zbatuar standardet bibliotekare ndërkombëtare. Në një kohë të zhvillimit të vrullshëm teknologjik, roli i të dy bibliotekave kombëtare në zbatim të kësaj detyre është që të mundësojnë qasje në informacion për të gjithë përdoruesit, kudo e në çdo kohë.

Konferenca u rekomandon të dy bibliotekave partnere, BKUK dhe BKSh, të theksojnë si përparësi integrimin biblio-webografik të tyre në portalet e përbashkëta europiane (EUROPEANA) dhe botërore (World Digital Library), si dhe t'i shmangen humbjes së energjisë dhe potencialeve në kinse-integrime, që u largohen këtyre përparësive.

U rekomandon bibliotekave marrjen e masave për kontrollin dhe vendosjen e marrëdhënieve të pronësive institucionale dhe të drejtave të autorit për realizimin e bibliografive kombëtare duke respektuar parimet dhe legjislacionin më të përparuar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Duke ditur se të dy bibliotekat kombëtare, ajo e Shqipërisë dhe ajo Kosovës, kanë një rol të veçantë në ndërtimin e Bibliografisë Kombëtare, paraqitet nevoja e respektimit, unifikimit të praktikave dhe zbatimit të standardeve nga të dyja institucionet.

Konferenca u bën thirrje drejtuesve të dy bibliotekave, të BKSh dhe BKUK, të forcojnë porositë administrative për zbatimin e standardeve biblio-webografike, si dhe të ushtrojnë kompetencën drejtuese në monitorimin e zbatimit të tyre.

Konferenca rekomandon përshpejtimin e botimit, në shërbim të publikut, të Bibliografisë kombëtare të BKSh (1555 - 1912 & 1913 - 1944) dhe të Bibliografisë së librit shqip në ish-Jugosllavi (1944 - 1984).

Konferenca shpreh vullnetin që ky takim shkencor pune të shërbejë njëherësh edhe si pikënisje për fillimin e botimit të Bibliografisë Kombëtare të Librit Shqip dhe të Artikujve të Periodikut Shqiptar në formë elektronike në bibliotekat tona, si investim kombëtar që kërkon një bashkëpunim të dy Bibliotekave Kombëtare me organizmat qeveritare dhe jo qeveritare në mënyrë që të përmirësohet shërbimi si për komunitetin e bibliotekës, ashtu edhe të shoqërisë sonë në tërësi.

Prishtinë, më 24 nëntor 2009

Në këtë numër

PËR NJË BIBLIOGRAFI KOMBËTARE TË LIBRIT SHQIP 4

GJENDJA DHE PERSPEKTIVAT E SHËRBIMEVE ELEKTRONIKE NË KOSOVË 8

PROBLEMATIKA E VLERËSIMIT NË SHËRBIMET BIBLIOTEKARE 12

SHËRBIMET E BIBLIOTEKËS NDAJ LEXUESIT.....15

HISTORIKU I BIBLIOTEKAVE UNIVERSITARE NË KOSOVË ...20

FONDI I SEKTORIT TË VENDLINDJES NË BIBLIOTEKAT PUBLIKE 24

TRASHËGIMIA E KOSOVËS ËSHTË SHTËPIA JONË ...30

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota
Kryeredaktor: Fazli Gajraku
Këshilli redaktues: Besim Kokollari, Bukurije Haliti
Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

U ORGANIZUA NË PRISHTINË

EDICIONI IV I KONFERENCËS KOMBËTARE TË BIBLIOTEKONOMISË

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, si institucion kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri - Kosovë, mbajti më 23 - 24 nëntor 2009, në Prishtinë, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, edicionin e katërt me temën *"Nga bibliografia te webografia e librit shqip"*.

Kjo Konferencë organizohet që nga viti 2006. Është organizim i përbashkët i këtyre dy Bibliotekave Kombëtare - të Kosovës dhe Shqipërisë dhe mbahet nën kujdesin dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë.

Në hapje, drejtori i BKUK-së - Sali Bashota theksoi rëndësinë që do të ketë kjo Konferencë, ku referojnë specialistë nga Kosova dhe Shqipëria për çështje të bibliografisë, standarde të përshkrimit bibliografik dhe nëpërmjet interpretimit dhe vlerësimit për çështje esenciale dhe praktike nga kjo fushë, ata do të ndihmojnë projektet e përbashkëta të këtyre dy bibliotekave që përkojnë me hartim të bibliografisë kombëtare shqiptare në formë elektronike dhe në formë të shtypur.

Ndërsa, drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë - Aurel Plasari, pohoi se tema që është zgjedhur prek nervin e bibliotekave, dhe ka çka të diskutohet, sepse është një çështje që krijon debat edhe sot në fushën e shkencës së librit dhe të shkencës së bibliotekonomisë.

Konferenca u përshëndet edhe nga ambasadori i Shqipërisë në Kosovë - z. Islam Lauka, si dhe rektori i Universitetit të Prishtinës - Mujë Rugova.

Në këtë edicion u trajtuan probleme, që përkojnë me rregullat dhe risitë e

Hapja solemne e Ediciont IV të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

përshkrimit bibliografik në biblioteka; standarde që përdoren në biblioteka; praktika të punës bibliografike në të dy bibliotekat kombëtare; metodat shkencore të kërkimit bibliografik; zhvillimet gjuhësore e kulturore me ndikim të drejtpërdrejtë në standardet bibliografike; hartimin e bibliografive moderne përmes shfrytëzimit të teknologjisë kompjuterike, si dhe me aplikimin e metadatave alternative në ndërtimin e bibliografive.

U analizuan probleme teorike dhe praktike për hartimin e bibliografive, për respektimin e standardeve ndërkombëtare, hartimin dhe botimin e bibliografive kombëtare në formë elektronike

Gjatë dy ditëve të Konferencës referuan menaxherë të bibliotekave kombëtare, universitare, publike, specialistë të shkencës së bibliotekonomisë nga të dy vendet: Afërdita Sharxhi: *"Bibliografia e arsyetuar-kontribut në fushën e studimeve"*; Tahir Foniqi: *"Kontribut për një bibliografi"*; Maksim Gjinaj: *"Disa drejtime themelore të kërkimit bibliografik"*; Muharrem Halili: *"Katalogu alfabetik - normat dhe standardet"*; Ramazan Vozga: *"Veçori të hartimit të bibliografive retrospektive"*; Farfuri Xhaja: *"Standardet e përshkrimit bibliografik dhe bibliografia kombëtare"*; Fahrije Simnica: *"Libri i rrallë dhe i vjetër dhe standardet e përshkrimit bibliografik"*; Jehona Shala: *"Sfidat e përshkrimit bibliografik të librit shqip"*; Nehat Krasniqi: *"Përshkrimi bibliografik i dorëshkrimeve arabe"*; Besim Kokollari: *"Automatizimi i bibliografive: nevoja për standardizimin e përcaktuesve"*; Behije Luga: *"Përgatitja e bibliografisë kombëtare në formë elektronike"*, si dhe Violeta Viso: *"Ekzemplari i detyruar dhe bibliografia kombëtare"*.

Në fund të kësaj konference u hartuan dhe u miratuan Konkluzionet e Konferencës, që rekomandojnë një sërë masash, të cilat mundësojnë bashkëpunimin e efektshëm mes Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Durim Hasaj

PËR NJË BIBLIOGRAFI KOMBËTARE TË LIBRIT SHQIP

DR. SALI BASHOTA

Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

25 Nëntori është Dita e Bibliotekës. Çdo vit, me aktivitete të ndryshme, festohet kjo Ditë e veçantë për bibliotekat e Kosovës. Pra, sivjet Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e shënon 65-vjetorin e themelimit të saj. Është viti i dytë i kremtimit në shtetin e pavarur të Kosovës. Në këtë frymë solemne, do të zhvillohen edhe aktivitetet e Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë është organizim i përbashkët i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe mblidhet nën kujdesin dhe mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve të Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, si dhe të Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sportit të Kosovës.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është bashkëthemeluese e dy veprimtarive të rëndësishme për librin dhe bibliotekat. Në vitin 2003 bashkë më Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë e themeloi manifestimin ndërkombëtar *Java e Bibliotekës në Kosovë*, ndërsa në vitin 2006 bashkë me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë e themeloi *Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë*.

Në edicionet e deritanishme të këtyre dy manifestimeve janë paraqitur dhe zhvilluar shumë projekte të rëndësishme me karakter profesional e shkencor dhe, gjithsesi, është krijuar mundësia më e mirë për të avancuar veprimtarinë dhe misionin e bibliotekave në shoqërinë e sotme.

Në këtë drejtim, Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, e cila është veprimtari e përbashkët e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, tashmë është bërë ngjarje kryesore kulturore për bibliotekat kombëtare të dy shteteve, Shqipërisë dhe Kosovës.

Në kuadër të edicioneve të përvitshme në Tiranë dhe Prishtinë, deri më tani janë trajtuar temat bosht: *Bibliotekat shqiptare në botën e re demokratike, Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare* dhe *Biblioteka-urë lidhëse mes dijes dhe publikut*, ndërkaq edicioni IV i Konferencës do të përqendrohet në paraqitjen e kontributeve të specialistëve nga Shqipëria dhe Kosova në temën: *Nga Bibliografia te Webografia e librit shqip*.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, dy qendrat kryesore të bibliotekarisë së dy vendeve, kanë realizuar në të kaluarën dhe po i realizojnë tani me një angazhim të pakursyer shumë projekte të përbashkëta në interes të zhvillimit të bibliotekarisë sipas standardeve më të avancuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë drejtim, edhe tema, e cila do të shqyrtohet me kumtesa të veçanta dhe sigurisht me debate shkencore në edicionin e këtij viti: *Nga Bibliografia te Webografia e librit shqip*, para së gjithash, është me interes për burimet e informacionit, edhe sa i përket prezantimit të bibliografive elektronike në internet.

Gjithsesi, referimet e specialistëve nga Shqipëria dhe Kosova, që kanë të bëjnë me përgatitjen e bibliografisë retrospektive të librit shqip, pastaj me standardet e përshkrimit bibliografik, me përgatitjen e bibliografisë shqiptare në formë elektronike etj., do të ofrojnë mundësi për interpretim dhe vlerësim të çështjeve esenciale që kanë të bëjnë me shërbimet e bibliotekave tona përbrenda niveleve të caktuara të bashkëpunimit, si dhe inicimit të projekteve të përbashkëta në shumë fusha. Kështu që, botimet në gjuhën shqipe, kudo që ndodhen ato, mund të kontribuojnë në hartimin e Bibliografisë Kombëtare Shqiptare, në formë elektronike dhe në formë të shtypur, pra të botuar.

Një ndër arritjet më të mëdha të bibliotekarisë shqiptare, gjithsesi, do të ishte krijimi i Katalogut përmbledhës të librit shqip, për të prezantuar botimet shqiptare edhe në Qendrën Bibliotekare të Kompjuterizuar në Rrjet (OCLC-Online Computer Library Center), pra në Katalogun Botëror(WorldCat).

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë ofron shkëmbimin e ideve dhe përvojave profesionale në fushën e bibliotekarisë në përgjithësi, ndërsa ky edicion do të ofrojë mundësinë më të mirë për të iniciuar dhe realizuar në periudha të caktuara çështje teorike e praktike të bibliografisë kombëtare në veçanti.

Urojmë që kontributet e pjesëmarrësve në këtë Konferencë shkencore, me kumtesat dhe diskutimet e tyre gjatë këtyre dy ditëve, të jenë sa më frytdhënëse në realizimin e synimeve të përbashkëta për modernizimin e bibliotekave shqiptare.

Prishtinë, 23 nëntor 2009

Fjalim me rastin e hapjes solemne të Edicionit IV të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë me titull: *Nga bibliografia te webografia e librit shqip*, të mbajtur më 23-24 nëntor 2009, në Prishtinë.

MANIFESTIM

65-VJETORI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, më 25 nëntor 2009, në një manifestim solemn, ka shënuar 65-vjetorin e themelimit, në prani të personaliteteve politike, kulture e intelektuale të Kosovës, si dhe në praninë e ambasadorit të ShBA-ve në Prishtinë - z. Christopher W. Dell.

Ky manifestim është hapur me një fjalim të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës z. Sali Bashota, i cili ka folur për historikun, sfidat dhe të arriturat e këtij institucioni bibliotekar qendror të Kosovës dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar, që mbledh, përpunon dhe ruan materialet bibliotekare me vlerë dokumentare për kulturën, artin dhe shkencën.

Drejtori i Bibliotekës, gjatë këtij fjalimi, ka përmendur në mënyrë të veçantë rezultatet që ka arritur ky institucion për këto 9 vite të pasluftës, si: ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të BKUK-së, si dhe ndihmën bibliotekave të të gjitha tipave në Kosovë, formimin e bibliotekave të veçanta dhe bibliotekave legatë, pasurimin e koleksioneve, implementimin e Programit Aleph 500, ndihmën e institucione ndërkombëtare në realizimin e shumë projekteve të BKUK-së, në veçanti ndihmën e Ambasadës së ShBA-ve, e cila për këto vite të pasluftës ka vijuar ta ndihmojë BKUK-në në shumë projekte të saj, themelimin e dy aktiviteteve të rëndësishme, të cilat organizohen brenda një viti, në të cilat referojnë ekspertë ndërkombëtare dhe vendës për probleme të bibliotekave dhe bibliotekarisë: "Java e Bibliotekës në Kosovë" dhe "Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë" etj.

Manifestimi i 65-vjetorit i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Ndërsa ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - z. Enver Hoxhaj, në fjalën e tij ka theksuar se BKUK është monument i kulturës dhe rezistencës shqiptare, dhe se historia dhe rrugëtimi i saj është një tregues i mire i pozitës që ka pasur Kosova gjatë periudhave të ndryshme. Z. Hoxhaj, po ashtu, ka uruara për punën dhe të arriturat e BKUK-së, duke premtuar përkrahje të MAShT-it për realizimin e të gjitha projekteve që lidhen me zhvillimin e bibliotekës.

Me një fjalim të veçantë, përshëndeti edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës - Christopher W. Dell, i cili theksoi se ruajtja e historisë dhe e kulturës së një shteti janë iniciativa të vlefshme dhe thelbësore për të kultivuar krenarinë qytetare mes shtetasve dhe tolerancën e përbashkët.

Ambasadori Dell inkurajoi që Biblioteka Kombëtare të ruaj arritjet dhe kontributet, duke shërbyer si frymëzim për të gjithë kosovarët që janë duke hulumtuar anët e ndryshme të historisë, kulturës, artit, muzikës, që përbën një strukturë të shoqërisë që me krenari e quajmë shteti i Kosovës.

Në këtë ceremoni të 65-vjetorit të BKUK-së, nga drejtori i Bibliotekës - z. Sali Bashota, janë dhënë mirënjohje për ambasadorin Christopher Dell, për kontributin dhënë BKUK-së nga ambasada e SHBA-ve në Prishtinë. Mirënjohje, për kontributin në fushën e zhvillimit të BKUK-së, i janë dhënë edhe ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - z. Enver Hoxhaj dhe drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë - z. Aurel Plasari.

Me rastin 65-vjetorit të BKUK-së, Muharrem Halilit i është dhënë çmimi - punëtor i dalluar, ndërsa, po ashtu, për kontributin e tyre shumëvjeçar, janë shpërblyer edhe ish-punëtorët e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës: Hazir Shala, Rrahim Ademi, Haxhi Vokshi, Yzeir Bylykemini, Idriz Mehmeti, Mumin Slivova, Zeqir Gkllasoviku, Beqir Krasniqi dhe Tahir Foniqi.

Durim Hasaj

SHPIRTI I SHTETIT TUAJ QËNDRON PËRBRENDA KËTYRE MUREVE TË BIBLIOTEKËS

/ Vijon nga ballina /

Shumë institucione kontribuojnë në këtë përpjekje. Muzetë - aty ku njerëzit mund të kënaqen në veprat e artit dhe eksponatet e gjeneratave të mëhershme dhe bashkëkohore. Qendrat kulturore - ku ata përjetojnë begatinë e muzikës, vallëzimit dhe teatrit. Arkivat - ku ata marrin informata për gjenezën e evolucionit të institucioneve gjyqësore dhe qeveritare. Natyrisht, bibliotekat janë ato që ofrojnë një shërbim thelbësor në ruajtjen kulturore dhe historike të një shteti, duke iu ofruar njerëzve qasje të dorës së parë të mendimeve dhe fjalëve të gjeneratave të mëhershme. Poezia, filozofia, letërsia artistike dhe drama e popujve tuaj ju presin në faqet e shumë librave dhe doreshkrimeve të ruajtura brenda këtyre mureve.

Pa këto institucione - muze, qendra arti, arkiva dhe biblioteka - një shtet nuk mund të ruajë, kuptojë dhe shpjegojë me efektivitet të kaluarën e vet. Këto institucione duhet të bëjnë më shumë se sa vetëm të theksojnë arritjet kulturore dhe historinë e shumicës së popullatës së një shteti. Ata duhet të jenë të kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës. Ata duhet të sigurojnë se historia, eksponatet, veprat artistike, ndërtesat, shkrimet dhe filozofitë - e të GJITHË popujve po ruhen dhe regjistrohen për gjeneratat e ardhshme. Suksesi juaj si një demokraci multietnike kërkon që të gjithë qytetarët të kuptojnë dhe respektojnë kontributet që ka dhënë secili prej komuniteteve të shtetit të Kosovës.

Ambasadori Christopher W. Dell pranon mirënjohjen për kontributin e dhënë BKUK-së nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë

Siç e kuptova unë, kjo bibliotekë e luan këtë rol dhe si e tillë nuk është vetëm simbol. Është edhe një tërësi e shtetit multietnik të Kosovës. Shpirti i shtetit tuaj qëndron përbrenda këtyre mureve dhe sikur edhe gjendet historia juaj këtu edhe ardhmja që do ta krijoni do të gjendet brenda këtyre mureve.

Përveç teksteve të pasura të shqiptarëve të cilat ju i ruani, ju keni koleksione të serbëve, turqve dhe boshnjakëve të cilat i ruani njëjtë. Shteti im është krenar që ka kontribuar në këtë përpjekje. Ne i gëzohemi bashkëpunimeve të ardhshme me këtë bibliotekë dhe shpresojmë të kemi përkrahje nga qeveria në vazhdimin e ruajtjes së trashëgimisë së të gjitha komuniteteve të cilat përbëjnë strukturën e shoqërisë kosovare. Pikërisht ky diversitet, kjo përzierje e rrymave etnike, fetare, historike dhe kulturore e bëjnë Kosovën këtë që është tani.

Po ashtu, ju inkurajoj që Biblioteka Kombëtare të dëshmojë thirrjen "kombëtare" duke festuar të gjitha pjesët e shtetit tuaj. Bëhuni një bibliotekë që përfaqëson të gjitha komunitetet që kanë kontribuar në të kaluarën e shtetit tuaj. Ruani arritjet dhe kontributet e tyre, shërbeni si frymëzim për të gjithë Kosovarët që janë duke hulumtuar anët e ndryshme të historisë, kulturës, artit, muzikës, që përbën një strukturë të shoqërisë që me krenari e quajmë shteti i Kosovës.

BIBLIOTEKAT NË SHËRBIM TË KOMUNIKIMIT TË KULTURAVE

ARTA BUZHALA,

Koordinatore e Bibliotekës së Këndit Amerikan në BKUK

Komunikimi kulturor mes popujve e tejkalon çdo formë apo lloj tjetër të komunikimit, qoftë ai ekonomik, politik, komercial, etj., por natyrisht se nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin. Komunikimi kulturor e kapërcen çdo lloj pengese politike për shkak se ai është kultivuar në saje të kontakteve të gjata historike e shoqërore të popujve, në radhë të parë. Ai hynë në mesin e njerëzve, integrohet në shpirtin dhe mendjen e tyre dhe kultivohet me tendencë që të zgjasë.

Për vite me radhë, ky lloj komunikimi është kultivuar sidomos mes popullit shqiptar dhe atij amerikan. Natyrisht se në vitet e fundit mes popujve tanë ka shpërthyer një komunikim në fusha të ndryshme të cilat veç se e plotësojnë njëri-tjetrin. Por që komunikimi kulturor është bërthama e marrëdhënieve afatgjata pasi nënkupton diçka më shumë se interesi i përkohshëm ekonomik, pra kultivon ndjenjën e dashamirësisë. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se një komunikim i këtillë kulturor për çfarë pretendojmë këtu transmetohet përmes letërsisë, përmes njohjes së kulturës së njëri-tjetrit, përmes filmit e aktiviteteve të tjera. Ku tjetër bashkëtakohen këto elemente më së miri se sa në një bibliotekë.

Për këtë qëllim, më 20 nëntor të vitit 2003, u pat themeluar Biblioteka e Këndit Amerikan në Prishtinë si rezultat i partneritetit të mirë mes institucioneve kosovare dhe amerikane. Këndi, një bibliotekë e llojit të vet, e veçantë dhe karakteristike me shërbimet dhe koleksionet e saj ushtron veprimtarinë në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Këndi Amerikan është një ndër bibliotekat më të rëndësishme që u ofron përdoruesve të saj informacione për kulturën, traditat, letërsinë, politikën, ekonominë, jetën, shkollën, e shumë çështje të tjera lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Që prej themelimit ka qenë një vend tërheqës jo vetëm për të rinjtë, që synojnë të shkollohen në universitetet dhe kolegjet e njohura amerikane, por edhe për grupet e tjera të shoqërisë sonë, të cilat kanë dëshirë të dinë më shumë për Amerikën.

Biblioteka e Këndit Amerikan, e cila gëzon një mbështetje si nga Ambasada e ShBA-ve në Prishtinë, ashtu edhe nga BKUK, e kryen këtë mision përmes formave të ndryshme të komunikimit me përdoruesin e vet, qoftë përmes koleksioneve të saja të formateve të ndryshëm, si libra, revista, gazeta, DVD, internet, qoftë edhe përmes aktiviteteve të ndryshme edukative, arsimore e kulturore. Në këtë kuadër, koleksioni i kësaj biblioteke paraqet një dritare të mirë të gjithë traditës dhe kulturës amerikane me llojshmërinë e vet. Ndërsa në kuadër të aktiviteteve të shumta që mëtojnë shkëmbim reciprok kulturor janë sjellë të flasin, ligjërojnë, prezantojnë si personalitete amerikane ashtu edhe kosovare. Ndër to mund të veçohen aktivitetet e rregullta javore për mësimin e gjuhës angleze me profesorë amerikanë për grup-mosha dhe bashkësi të ndryshme etnike të Kosovës, pastaj aktivitete për njohjen e kulturës dhe traditës amerikane në formë kursesh, ligjëratash, prezantimesh e deri të shfaqjet e filmave. Këto aktivitete të formave të ndryshme kanë për qëllim rritjen e komunikimit të drejtë mes Kosovës dhe Amerikës, të nxitjes së shkëmbimeve kulturore dhe të njohjes e afirmimit më të mirë mes dy kulturave tona.

GJENDJA DHE PERSPEKTIVAT E SHËRBIMEVE ELEKTRONIKE NË KOSOVË

BESIM J. KOKOLLARI

Në një kërkim shkencor, me titull "Të ndërtosh koleksionet e Bibliotekës Digjitale të Kosovës: çka presin përdoruesit?", ndër të tjera kam shtjelluar edhe problematikën e shërbimeve ekzistuese digjitale në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kjo kishte të bënte me identifikimin dhe evidentimin e hapave të ndërmarrë nga BKUK lidhur me ofrimin e shërbimeve elektronike dhe digjitale për përdoruesit e saj, në veçanti dhe popullsinë e Kosovës, në përgjithësi. Në të vërtetë, ofrimi i shërbimeve elektronike paraqet hapin e parë drejt shërbimeve digjitale me të cilat, në kontekstin bibliotekar, nënkuptojmë mundësi vetë-shërbyese të përdoruesve, përfshirë edhe gjetjen e materialeve me tekst të plotë, si libra digjital, revista digjitale, audio-video, etj.

Në këtë kontekst, BKUK ka ndërmarrë disa hapa drejt ofrimit të shërbimeve elektronike dhe digjitale për përdoruesit e saj. Kështu, ajo ka realizuar projektin e sistemit të integruar bibliotekar Aleph 500, i cili u ofron qasje të lirë të gjithëve në katalogun e bibliotekës. Përveç kësaj, ajo ka abonuar në një numër burimesh elektronike, kryesisht baza të të dhënave, për të cilat mund të thuhet se nuk përdoren në masë të dëshirueshme. Këto shërbime, së bashku me uebsajtin e saj të ri, shënojnë një epokë të re drejt ofrimit të shërbimeve digjitale në BKUK. Ndryshe prej saj, bibliotekat e tjera publike të Kosovës, bibliotekat e fakulteteve dhe departamenteve të Universitetit të Prishtinës nuk ofrojnë ndonjë shërbim të mirëfilltë digjital apo elektronik me ndonjë përjashtim të vogël aty-këtu.

Tabela 1 në vijim paraqet shfrytëzimin e internetit në Kosovë karshi shfrytëzimit të tij në vendet fqinje. Përzgjedhja e vendeve për krahasim ka karakter edhe demografik edhe rajonal.

Tabela 1. Shfrytëzimi i internetit në Kosovë krahasuar me vendet fqinje

Vendi	Popullsia	Përdoruesit e internetit	E shprehur në % të popullsisë	Rritja e përdoruesve 2000-2008
Kosovë	1,804,838*	377,000	20.9 %	0.0 %
Maqedoni	2,066,718	906,979	43.9 %	2,923.3 %
Sllloveni	2,005,692	1,300,000	64.8 %	333.3 %
Shqipëri	3,639,453	750,000	20.6 %	29,900.0 %
Bosnja dhe Hercegovina	4,613,414	1,441,000	31.2 %	20,485.7 %
Serbia	7,379,339	3,300,00	44.7 %	725.0 %
Kroacia	4,489,409	2,244,400	50.0 %	1,022.2 %
Mali i Zi	672,180	294,000	43.7 %	0.0 %

** Nga vlerësimet e tanishme thuhet se Kosova ka mbi 2 milionë banorë.*

Meqë bibliotekat digjitale janë të lidhura ngushtë me teknologjinë e internetit, atëherë në vijim kemi dhënë disa statistika dhe analiza të shoqëruar me shpjegime sipas nevojës. Këto analiza kanë të bëjnë me: 1) shfrytëzimin e internetit në Kosovë në krahasim me vendet fqinje, 2) shfrytëzimi i uebsajtit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në krahasim uebsajtet e bibliotekave kombëtare në rajon, dhe 3) shfrytëzimi i burimeve elektronike në të cilat ka abonuar Biblioteka.

Këto shifra statistikore janë marrë prej Internet World Stats (Internet World Stats, 2009), një uebsajt i cili ofron analiza të shfrytëzimit të internetit në shkallë vendi. Statistikat janë të bazuara në të dhënat e nxjerra në muajin dhjetor të vitit 2009. Ndonëse statistikat në tabelën 1 më lartë janë vetë-shpjeguese, vlen të përmendet se Kosova, sipas saj, zë vendin e parafundit pas Shqipërisë për shfrytëzimin e internetit me vetëm 20.0% të popullsisë. Nëse këtyre statistikave i shtohen vlerësimet e fundit për popullsinë e

Kosovës në 2, 180 686 milion banorë (Enti i Statistikës së Kosovës, 2009), atëherë del se përqindja e popullsisë së Kosovës që shfrytëzon internetin do të jetë më e ulëta në rajon me vetëm 17.3%. Në përgjithësi tabela 1 tregon një shtrirje dhe shfrytëzim ende të ulët të internetit në Kosovë që natyrisht ndikon në shfrytëzimin e shërbimeve elektronike që mund të ofrojnë jo vetëm bibliotekat por edhe institucionet e tjera të sektorit publik e privat të Kosovës.

Tabela 2 më poshtë paraqet trendët e shfrytëzimit të uebsajteve të bibliotekave kombëtare të Kosovës dhe të vendeve përreth saj.

Tabela 2. Shfrytëzimi i uebsajteve të bibliotekave kombëtare në rajon

Vendi	Institucioni	Domeni i uebsajtit	Shkalla e trafikut (mesatarja për 3 muaj)	Koha mesatare e kaluar në uebsajt	Prej kah hyjnë përdoruesit në atë uebsajt
Kosovë	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës	biblioteka-ks.org	14,739,812	1.5 min/ditë	Nuk ka të dhëna
Maqedoni	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Maqedonisë	nubsk.edu.mk	3,473,416	1.5 min/ditë	66.7% nga Maqedonia
Slloveni	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Sllovenisë	nuk.uni-lj.si (përfshinë edhe domenin e Universitetit të Lublanës)	19,717	4.6 min/ditë	78.6% nga Sllovenia
Shqipëri	Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë	bksh.al	2,538,476	2.3 min/ditë	Nuk ka të dhëna
Bosnje dhe Hercegovinë	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Bosnjës dhe Hercegovinës	www.nubbh	5,919,977	0.8 min/ditë	66.7% nga Bosnja dhe Hercegovina
Serbi	Biblioteka Kombëtare e Serbisë	nb.rs	206,900	4.1 min/ditë	59.1% nga Serbia dhe Mali i Zi
Kroaci	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kroacisë	nsk.hr	324,620	5.2 min/ditë	85.2% nga Kroacia
Mali i Zi	Biblioteka Qendrore Kombëtare e Malit të Zi	cnb.me	14,306,119	0.3 min/ditë	Nuk ka të dhëna

Që në fillim duhet theksuar se statistikat në tabelën 2 më lartë janë mbledhur prej uebsajtit statistikor-analizues të kompanisë Alexa Interent: www.alexa.com në muajin prill të vitit 2009. Sipas Alexa Internet, shkalla e trafikut llogaritet duke e bërë një kombinim të mesatares ditore të vizitorëve dhe të faqeve të vizituara për një periudhë 3 mujorëshe. Uebsajtet me numrin më të lartë të vizitorëve dhe faqeve të vizituara shkallëzohen kundrejt numrit 1 (Alexa Internet, 2009). Edhe pse të dhënat në tabelën 2 më lartë nuk janë testuar me ndonjë uebsajt analizues tjetër alternativë, prapë se prapë ato paraqesin një pasqyrë të mirë të shfrytëzimit të uebsajteve të bibliotekave kombëtare të vendeve përreth Kosovës.

Nga tabela më lart shihet se uebsajti i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës nuk gëzon ndonjë popullaritet të madh në krahasim me uebsajtet e bibliotekave kombëtare të vendeve të rajonit. Nga pikëpamja statistikore, shfrytëzimi i uebsajtit të BKUK-së është i përafërt me atë të Bibliotekës Kombëtare të Malit të Zi. Megjithatë, ka një epërsi të vizitorëve që qëndrojnë më gjatë në faqet e saja me një mesatare prej 1.5 minutave në ditë në krahasim me mesataren e kaluar në uebsajtet e bibliotekave të Malit të Zi dhe Bosnje e Hercegovinës, përkatësisht prej 0.3 dhe 0.8 minutave/ditë. Një informacion tjetër me rëndësi sa i përket statistikave në këtë tabelë është se përdoruesit më të shumtë të këtyre bibliotekave vijnë nga po ato vende ku funksionojnë ato. Edhe pse nuk ka të dhëna statistikore për vizituesit e uebsajtit të BKUK-së, nëse shikohet nga perspektiva e zhvillimit të një biblioteke digjitale

të Kosovës, kjo ndoshta mbase mund të interpretohet si një tregues se përdoruesit primar dhe kryesor të bibliotekës digjitale kombëtare të Kosovës mund të jenë po ashtu përdoruesit brenda territorit të saj.

Ndryshe nga shifrat e mësipërme, tabela në vijim paraqet një pasqyrë të shfrytëzimit të burimeve elektronike të EBSCOhost dhe Gale në të cilat ka abonuar Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës. Është me rëndësi të theksohet se bazat e të dhënave të EBSCOhost kanë qasje në tërë territorin e Kosovës, ndërsa burimet e Gale mund të shfrytëzohen vetëm në kompjuterët brenda objektit të BKUK-së. Kjo tabelë nuk i përfshinë edhe një numër burimesh të tjera elektronike në të cilat ka abonuar BKUK.

Tabela 3. Shfrytëzimi i burimeve elektronike në të cilat ka abonuar BKUK

Shfrytëzimi i materialeve me tekst të plotë për vitin:	Ebscohost	Gale	Gjithsej
2007	6487	228	
2008	3585	201	
2009	3719	55	
	13791	505	14296

Statistikat në këtë tabelë janë nxjerrë drejtpërdrejt nga raportet që ofrojnë këto kompani për abonentët e tyre. Nga tabela më lart shihet se ka një rënie të shfrytëzimit të burimeve elektronike të abonuara nëse bëjmë krahasim të vitit 2007 me dy vitet e mëvonshme. Sido që të jetë, tabela pasqyron një përdorim mjaft të ultë të burimeve elektronike në përgjithësi. Për këtë arsye duhet të hulumtohen shkaqet e një përdorimi të tillë. Ndoshta mund të supozojmë se mungesa e promovimit, marketingut dhe informimit se janë në dispozicion këto burime për përdoruesit, studentët, hulumtuesit, shkencëtarët dhe qytetarëve të tjerë të vendit ka bërë që të kemi një përdorim jo shumë të dëshirueshëm të tyre. Nëse marrim parasysh rrethanat në të cilën gjendet BKUK, si është e mundur një përdorim kaq i ultë i këtyre burimeve kur kemi 28,757 studentë të regjistruar në Universitetin e Prishtinës në vitin 2007/08 (Universiteti i Prishtinës), si dhe disa mijëra të regjistruar në universitetet private, që të gjithë po thuaj me të drejtë qasje në burimet e EBSCO-s? Përveç kësaj, vetë BKUK ka të regjistruar aty mes 3000 dhe 4000 anëtarë brenda vitit, kryesisht studentë. Një drejtim tjetër që duhet hulumtuar mund të jetë relevanca apo mosrelevanca e burimeve elektronike. Thënë ndryshe sa u përshtaten këto burime nevojave të përdoruesve apo anëtarëve të regjistruar të BKUK-së. Ndoshta një shkak tjetër mund të jetë edhe pengesa gjuhësore pasi këto burime ofrohen kryesisht në gjuhën angleze. Me sa di, ende nuk është bërë ndonjë hulumtim, raport apo analizë që do t'i jepte përgjigje pyetjeve paraprake. Natyrisht se kërkimi i përgjigjeve të tyre përmes ndonjë hulumtimi do të përbënte një kontribut të mirë për BKUK-në në radhë të parë dhe për shkencën e bibliotekarisë në Kosovë.

Në BKUK ekziston Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës, anëtare e eIFL.net (Informacione Elektronike për Biblioteka, një organizatë ndërkombëtare që i mbështet bibliotekat e vendeve në zhvillim). Konsorciumi është themeluar në vitin 2004 (Kokollari, 2004) dhe që prej atëherë ka arritur të sigurojë fonde për abonim në një varg burimesh elektronike. Një sukses tjetër i këtij Konsorciumi, i cili ka për qëllim ofrimin e shërbimeve digjitale dhe elektronike përmes abonimeve në nivelin institucional dhe vendor të Kosovës, është edhe përfitimi dhe zhvillimi i shkathtësive për negocim të ofertave abonuese, që është një kompetencë tejet e rëndësishme në punën e bibliotekarit. Së këndejmi, duhet që kapacitetet e këtij Konsorciumi të zhvillohen edhe në aspekte të tjera të veprimtarisë së tij, për shembull të vlerësimit të shfrytëzimit të burimeve elektronike dhe marketingun e promovimin e tyre që do të rriste shfrytëzimin e tyre.

Shërbimet digjitale, përfshirë edhe një varg shërbimesh elektronike që tashmë ofrohen përmes institucionit të BKUK-së, janë rruga që duhet të ndjekim. Në këtë kontekst, themelimi, krijimi dhe zhvillimi i një biblioteke digjitale në nivel kombëtar, e që do të ishte përgjegjësi e BKUK-së, përmes së cilës përdoruesit do të mund të gjenin jo vetëm burime elektronike të abonuara, por edhe trashëgimin e dokumentuar në forma të ndryshme do të përbënte zhvillimin më të shenjueshëm të BKUK-së në historikun e formësimit dhe zhvillimit të saj. Për rëndësinë e një biblioteke digjitale kemi shtjelluar tema gjetiu dhe nuk do ndalemi këtu në këtë punim pasi që del jashtë fushëveprimit të artikullit.

Në fund, të tri tabelat dhe ajo që shtjelluam më lart tregojnë se nuk ka një tendencë të rritjes së shpejtë të shfrytëzimit të burimeve elektronike, natyrisht të kufizuar në disa aspekte të shtjelluara më parë. Dhe kjo mund të ketë ndërlidhje me faktorë të ndryshëm, si për shembull shfrytëzimi i internetit në shkallë vendi (tabela 1 më lart) mund të ketë lidhje me mungesën e shtrirjes së infrastrukturës. Ose mungesa e infrastrukturës së internetit në vetë Universitetin e Prishtinës mund të ndikojë drejtpërdrejt në shfrytëzimin e ultë të burimeve elektronike të përshkruara në tabelën 2 dhe 3 më lart. Duke i parë trendet statistikore të përshkruara në këtë artikull, edhe themelimi i një biblioteke digjitale nuk do të premtojë një shfrytëzim të madh e të menjëhershëm, gjithnjë nëse shkohet me një promovim pasiv apo edhe shërbime dhe materiale digjitale të kufizuara. Prandaj, një planifikim i kujdesshëm, përmbajtje të përzgjedhura dhe ofrimi i shërbimeve në mënyrë efektive, duke përfshirë një fushatë marketingu dhe promovuese, do të duhej të bëheshin krahas krijimit dhe zhvillimit të bibliotekës digjitale. Një sukses të dukshëm kishte hapja e bibliotekës digjitale Europeana, e cila në saje të marketingut dhe promovimit, por në një masë edhe të përmbajtjes, arriti të tërhiqte miliona përdorues duke shkaktuar edhe mbylljen e përkohshme të saj për shkak të trafikut të përballueshëm (Europa Press Releases RAPID, 2008). Orientimi dhe ofrimi i shërbimeve digjitale bibliotekare dhe të informacionit në përgjithësi është i pashmangshëm pasi që këto janë trende të një shkalle më të gjerë, pra të orientimit të shoqërive moderne kah shërbimet dhe burimet elektronike/digjitale të natyrave të ndryshme.

Referencat:

- Alexa Internet. (2009). Analizat janë marrë më 7 prill 2009, prej http://www.alexa.com
  Enti i Statistikës së Kosovës. (2009). Indikatorë demografik. Marrë më 23 dhjetor 2009, prej: http://www.ks-gov.net/ESK//;
- Europa Press Releases RAPID. (2008). Europeana website overwhelmed on its first day by interest of millions of users. Marrë më 23 prill 2009, prej: http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=MEMO/08/733;
- Kokollari, B. (2004). U themelua Konsorciumi i bibliotekave elektronike të Kosovës. *Biblioletra, 1* (2), 12;
- Universiteti i Prishtinës. Statistikat për studentët vijues 2007/08. Marrë më 7 prill 2009 prej: http://web.uni-pr.edu/repository/docs/formulariperjokosovarsipasnacionalitetit.pdf

PROBLEMATIKA E VLERËSIMIT NË SHËRBIMET BIBLIOTEKARE

Qazim Azizi

(Biblioteka Ndërkomunale e Gjilanit)

Fjalët kyçe: Vlerësimi, shërbimi bibliotekar, benchmarking, menaxhimi në bibliotekë

HYRJE

Fundi i viteve të shekullit XX dhe fillimi i shekullit XXI, karakterizohet si epokë e kompjuterizimit, informatikës - si shkencë, dhe informacionit të shpejtë. Pas paraqitjes së ICT-së dhe formave të tjera të marrjes, ruajtjes dhe afrimit të informacionit për publikun e gjerë, janë hapur dhe janë identifikuar edhe një mori dilemash dhe probleme të cilat kërkojnë një analizë, interpretim dhe zgjidhje të duhur.

Presioni i madh i përdorimit të internetit, UEB faqet e shumta i detyruan bibliotekat dhe të gjitha shërbimet e tyre që të merren në mënyrë specifike me lexuesit që kërkojnë informacione dhe shërbim nga bibliotekat. Dhe, natyrshëm, hyrja e kompjuterit në shërbimet bibliotekare ka shkaktuar edhe problemin e vlerësimit të këtyre shërbimeve dhe të asaj se çfarë dhe si duhet të matet, si të vlerësohet kualiteti i punës së shërbimeve në biblioteka.

Ky punim është përgatitur duke u shërbyer dhe nga literatura e nxjerrë nga autorët Baker, Sh., L. Lancaster, Wilfrid. F., Saracevic, Tefko, Petra Ballog, T. Rubin, Du Mont, P. etj..

Bibliotekat me shërbimet e tyre si: pasurimi, katalogimi, qarkullimi etj., filluan me shpejtësi të vendosnin shënimet e tyre në rrjetin digjital. Prandaj, bibliotekarët dhe shërbimet bibliotekare reflektuan me kohë duke u pajtuar se duhet një edukim dhe shkollim i mëtutjeshëm dhe më aktiv i tyre në shkencat e informatikës.

Puna në biblioteka kërkonte një vlerësim, për cilësinë dhe kualitetin e saj; të dihej se çka bëhej; të hidhej në dritë puna e bibliotekarëve, duke parë se kishte presion, fillimisht më të lehtë dhe pastaj edhe më i shtuar nga financuesit, të cilët mendonin se bibliotekat janë shpenzues të mëdhenj të buxhetit dhe në të njëjtën kohë nuk japin rezultate dhe asnjëherë raport të suksesshëm në punë. Fakti se ata, financuesit, nuk e njihnin fare, apo e njohin pak mënyrën e funksionimit të bibliotekave si dhe rregullimin e brendshëm; të departamenteve, (sektorëve) të bibliotekës, i bënë të kenë paragjykime për mosefikasitetin dhe shpesh edhe për mospunën në biblioteka.

Në Kosovë, të dhënat për përmasat dhe numrin e shërbimeve, të cilat merren si vlerësim i punës së bibliotekave që nga ato shkollore, komunale, regjionale, (publike) dhe deri te BKUK-ja, i janë dhënë gjatë tërë kohës Entit Statistikor të Kosovës.

Vlerësim të shërbimeve janë bërë edhe përmes shkrimeve të herë-pashershme në revistën e Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës "Biblioteka", këto shënime statistikore mblidhen dhe analizohen edhe nga shërbimi i Departamentit për Hulumtim i BKUK-së, dhe në shumë nga artikujt në revistën "Biblio*letra*".

Shërbimi për lexuesit e shumtë të BKUK-së, që kanë qasje në shumë baza të njohura elektronike të të dhënave, siç janë: EBSCO, Oxford journals, Oxford scholarship, Electronic journals etj., evaluimi i të gjitha këtyre shërbimeve bëhet përmes serverit kryesor të bibliotekës, siç ndodh edhe në bibliotekat tjera simotra.

Sikur edhe shkencat e tjera, hulumtimi në çështjet e bibliotekarisë duhet të ketë përparësinë e shoqërisë dhe të publikut, dhe duhet pasur të qartë se kemi ngecur mjaft në këto çështje dhe që bota tani është shumë më afër neve.

Vlerësimi për efikasitetin e shërbimeve bibliotekare në SHBA dhe më vonë në Evropën Perëndimore ka filluar në vitet 60-të të shek. XX, me emrat e njohur të shkencës së bibliotekarisë. Bibliotekarët europianë, pas atyre amerikanë, ishin gjithnjë nën presionin e daljes me raporte më të plota, për shërbimet e shtrenjta dhe harxhimet e tyre pa ndonjë mbulesë në bibliotekat e tyre. Kjo ndodhte sepse kishte një qasje tjetër në shërbimet e sistemeve ekonomik të shteteve në perëndim, ishte llogaridhënia për çdo mjet të harxhuar.

Duke u përgjigjur në pyetjen se pse duhet vlerësimi, efikasiteti i punës së shërbimeve bibliotekare në përgjithësi, studiuesit përgjigjen se qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit është njoftimi me atë se çfarë, çka dhe si punohet në bibliotekë. Si të paraqiten rezultatet e punës para atyre që janë përgjegjësit tanë?; Me çka merren bibliotekat dhe shërbimet e tyre?; Si punohet dhe si është paramenduar të punohet duke pasur të qartë planet strategjike të punës?; Cili do të jetë efekti i ekzistencës së bibliotekave dhe shërbimeve bibliotekare?

Është e çartë se publiku gjithashtu dëshiron dhe ka të drejtë dhe nevojë të dijë për vlerën , për kualitetin e

shërbimeve që i merr nga bibliotekat e tyre. Por, nëse biblioteka nuk e ka bërë përpara vlerësimin e shërbimeve dhënë qytetarëve, lexuesve të vet, mund të ndodh që, siç thonë shpesh Walsh dhe D'Elia, vlerësimet e publikut të mos jenë aspak reale, sepse ata kanë perceptim të ndryshëm për shërbimet që jep biblioteka për ta.

Vlerësimi nuk mund të jepet vetëm nga shikimi i jashtëm i bibliotekës ose vetëm nga orari i saj dhe konkludojnë vetëm për njërën anë të medaljes. Kush duhet të përkujdeset për anën tjetër?

Në anën tjetër, kriteri kryesor i vlerësimit të saktë të punës si dhe i shërbimit në bibliotekë, duhet të nxirret nga analiza e shfrytëzimit të burimeve të informacioneve, shfrytëzimi i fondeve si dhe vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i efekteve që jep në këtë rast ky shërbim bibliotekar. Në këtë rast bibliotekarja e njohur prof. Dr. Petra Balog vlerëson se: "Një bibliotekë dhe një drejtues i mirë i saj duhet të ketë parasysh një rritje të vazhdueshme të i numrit të anëtarëve të saj si dhe të kualitetit të shërbimeve për përdorues- lexues".

Pse duhet të matet dhe vlerësohet efektiviteti i punës në bibliotekë? Një hulumtim i rëndësishëm i R. Orr, që ka bërë viteve të 70-të në fushën e vlerësimit të punës së shërbimeve bibliotekare, në punimin e tij me titull: *Measuring the goodness of library serviles*, na jep një pasqyrë shumë të qartë për matjen dhe vlerësimit. Duke analizuar këtë problem, ai jep dy matës kryesorë të vlerësimit: Kualitetin, sa i mirë është shërbimi (nënkuptohet matja e kapaciteteve bibliotekare për të përmbushur nevojat e lexuesve); Vlerën, sa të mira na sjell shërbimi i mirë; (një mori e aftësive të dobishme të përfituara nga shfrytëzuesit përmes shërbimeve nga biblioteka). Por, në të njëjtën kohë



bibliotekari i njohur R. Orr sqaron se vlerësimi i saktë i shërbimeve në bibliotekari nuk është i mundur, sepse, secila bibliotekë është e veçantë (sui generis) kështu që për të vlerësuar drejt, duhen të kihen parasysh rrethanat në të cilat kryhen këto punë si dhe veprimtaria bibliotekare veç e veç.

Në vitet '80-të, metodat e vlerësimit janë avancuar edhe më shumë. Në literaturën bibliotekare, për çështjen e vlerësimit, autorët gjithnjë e më shumë fillojnë të përdorin terma ekonomikë, duke tërhequr vërejtjen në mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave të bibliotekave dhe të krahasimit të tyre. Nga Raportet statistikore, kërkohet që të zbatohen në praktikë dhe vlerësimi tani të shihet si pjesë e pandashme e udhëheqjes së bibliotekës dhe gjithnjë e më shumë të flitet për qëllimet e bibliotekës duke bërë vlerësimin adekuat të shërbimeve. Studiuesi i njohur i bibliotekarisë Lancaster, me publikimin e parë të doracakut të tij: "*The measurement and evaluation of library services"*, paraqet në mënyrë të qartë dhe në praktikë udhëzime dhe sqarime se si të zhvillohet dhe kërkohet në problematikën e ndjeshme të vlerësimit dhe kualitetit të shërbimit.

Teknikat dhe metodat e dhëna nga ky doracak filluan të përdoren në disa nga bibliotekat e SHBA-ve, duke dhënë rezultate të dukshme, duke u shtuar nevoja edhe e ribotimit dhe plotësimit të doracakut edhe me shembuj praktikë, dhe duke i dhënë një shtytje dhe peshë edhe më të madhe çështjes së vlerësimit.

Dhe, përfundimisht në vitet '80-të të shek. XX, në njërën nga konferencat e ALA-s, kur flitej për problematikën e vlerësimit me tematikë: "Efektiviteti në bibliotekë si një art i veçantë", ekonomisti dhe studiuesi i njohur Richard. A. Stayner, flet për Benchmarking-un (term ekonomik), i cili merret si instrument i krahasimit *të bibliotekës*

me vetveten, me bibliotekën tjetër të të njëjtit nivel, apo edhe me ndonjë organizatë të suksesshme.

Përdorimi i formës së mëparshme të shënimeve statistikore dhe të dhënat e tjera, nuk mund të merreshin si vlerësim i saktë i punës në bibliotekë, por forma e menaxhimit me bibliotekën si dhe vetëvlerësimin nga menaxherët dhe metodat teorike të praktikohen në vendngjarje. Kështu, Kronin shkon edhe më larg dhe kërkon që kjo, të bëhet me anë të formularëve standardë, në mënyrë që rezultatet të mblidhen, të analizohen dhe me to të shërbehet për të sofistikuar edhe më tej shërbimet cilësore të bibliotekave. Ai filloi vetë me praktikimin e metodave të këtilla, por, gjatë procedurave të shtrirjes, haste shpesh në vështirësi, nga vërejtjet e shumta që merrte nga vetë bibliotekarët në terren.

Statistikat tradicionale të madhësisë së fondit, pasurimi i rregullt me libra, orari i gjatë nuk janë elemente që tregojnë se një bibliotekë do të jetë e suksesshme, (të vlerësohet për kualitet të lartë dhe shërbim i mirë për lexuesit).

Se sa jemi të mirë dhe çfarë kualiteti shërbimesh kemi, këtë duhet ta shikojmë nga perspektiva e përdoruesve, lexuesve, anëtarëve, vendosja dhe vendndodhja fondeve, shënjimi i tyre në bibliotekë, stafi punonjës i bibliotekës, mënyra dhe shpejtësia e dhënies së përgjigjeve nga ato edhe më të pamundshmet, komoditeti - jo frustrimi etj.

Çka duhet të matim gjatë vlerësimit? - mjetet financiare, njësitë punuese, funksionimin, reklamimin, shfrytëzuesit - mosha, gjinia, dhe profesioni, bashkësia (shfrytëzues dhe jo shfrytëzues të bibliotekës), shërbimi, efekti (pozitiv/negativ), pasojat në lidhje me punën, ana ekonomike, shpejtësia e shërbimit, saktësia, parashikimi, përsosmëria (sa shpejt dhe sa saktë në të njëjtën kohë), vlera, besueshmëria, mirësjellja dhe kënaqësia e shërbimit. Qëllimi kryesor i shërbimeve kualitative duhet të jetë: që lexuesin e kënaqur nga shërbimi ta bëjmë të përhershëm (lojal), gatishmëria që lexuesi të shfrytëzojë fondet rregullisht (dhe nga kjo të shihet shkalla e kënaqësisë së tij me shërbimet që i bëhen) në mënyrë që ai në një mënyrë të bëhet edhe propagandues i bibliotekës edhe për shfrytëzuesit e tjerë.

Duke zgjedhur me kujdes aktivitetet, duke caktuar edhe qëllimin e krahasimit, po ashtu edhe mënyrën e interpretimit, analizimin, dhe mbledhjen e të gjitha shënimeve të përditshme në shërbime, ne mundë të bëjmë një rekapitullim matës së pari për vetveten, pastaj për bibliotekën, një krahasim në mes sektorëve të bibliotekës, dhe të krahasohemi edhe me biblioteka e tjera nga aspekti se: A jemi duke punuar sikur periudhën e mëparshme, ose më mirë !?; A mundë të jemi në konkurrencë?; A ka biblioteka të tjera që janë më të mira se ne, dhe se ne mund të mësojmë nga ata?

Por, a mund të bëhen edhe gabime në proces gjatë këtyre numërimeve dhe vlerësimeve të aktiviteteve dhe shërbimeve? - Po, dhe duhet pasur kujdes në atë se madhësia e fondeve nuk do të thotë edhe shërbimi më i mirë, si dhe numërimi për të njëjtin fakt dy herë.

Një vërejtje te National Performance Review, marrë nga ligjëratat e profesoreshës kroate K. Ballog sqaron se: "Në qoftë se një kritikë e marrë nga shfrytëzuesi përmirësohet kjo e përforcon lojalitetin e lexuesit ndaj bibliotekës. Ky është një fakt se për ata, biblioteka dhe shërbimi kanë respekt".

Cilët mund të jenë shkaktarët më të mëdhenj të pakënaqësive me shërbimet në bibliotekë? Mungesa e fondit ose e librit (nuk është në rafte); problemi i mosgjetjes së shfrytëzuesit me katalogun, skedarin në bibliotekë apo edhe në sallën e librave, kur nuk ka ndonjë sqarim apo informim nga biblioteka. Nga kjo del se; 96 % e lexuesve nuk ankohen aty për aty; 90 % e tyre nuk kthehen kurrë në bibliotekë; secili nga ata u tregon për këtë fenomen edhe 9 shfrytëzuesve të tjerë, dhe; 13% u flasin 20 apo edhe 30 njerëzve të tjerë, dhe kjo ndodh për shprehi shumë banale, si p.sh., nuk më intereson..., nuk e di..., nuk e kemi..., ankohu po të duash..., s'kam unë faj..., nuk e vlen barra qiranë të angazhohem për këtë gjë... etj.

Në këtë qasje si metodë kërkimore të vlerësimit të kualitetit të shërbimeve dhe kënaqësisë së shfrytëzuesit mundë t'i përdorim këto instrumente matëse: Pyetësorët; Anketat; Intervistimi; Raportet vjetore, periodike, si dhe Planet strategjike të bibliotekave (shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm).

Bibliotekat Kombëtare të Sllovenisë dhe Kroacisë janë të parat vendeve të rajonit që kanë filluar t'i përdorin këto instrumente matëse për vlerësim.

Kroacia dhe Sllovenia, përmes Instituteve të tyre të Statistikave dhe Standardeve kanë krijuar formularë unikë të harmonizuar me ata të IFLA-s ISO 11620 dhe 2789. Këta formularë (anketa, pyetësorë dhe intervista), përdoren për të lehtësuar punën shkencore për hulumtuesit e të gjitha fushave.

PËRFUNDIM

Nuk mundë të themi se gjendja e bibliotekave po ndryshon çdo ditë dhe të kënaqemi me këtë; se ato po ofrojnë shërbime më shumë dhe ne nuk duhet të brengosemi për mbarëvajtjen e tyre. Pikërisht për këtë dhe për ndryshimet e mëdha në këtë kohë (epokën e globalizimit) neve na duhet që me shpejtësi të përshtatemi dhe të marrim masat e duhura. Sikur edhe shkencat e tjera, hulumtimi në këtë shkencë duhet të ketë përparësinë edhe të shoqërisë edhe të publikut.

SHËRBIMET E BIBLIOTEKËS NDAJ LEXUESIT

(Disa nga format e nxitjes së leximit)

ZIZË REXHAJ - KRAJA

PËRVOJA

Duke punuar që një kohë, pra për disa vite, në një shërbim që është në komunikim të drejtpërdrejtë dhe të përditshëm me lexuesit, mund të sjell këtu disa përvoja, të cilat mund t'iu shërbejnë sadopak edhe atyre që punojnë në biblioteka shkollore. Kuptohet, lexuesi i bibliotekës shkollore është shumë specifik, por në fund të fundit edhe ai është lexues, i cili i ka disa kërkesa njësoj sikundër edhe lexuesit e tjerë. Përvoja e punës në shërbimin e informacionit në BKUK, tregon se komunikimi i kulturuar dhe profesional është faktori kryesor që vendos lidhje të qëndrueshme ndërmjet lexuesit dhe bibliotekës, respektivisht të lexuesit dhe të librit në bibliotekë. Përveç dhënies së informacionit profesional, lexuesi në përgjithësi, kurse ai shkollor në mënyrë të veçantë kërkon në bibliotekë ambient të komunikimit miqësor dhe mirëkuptimit. Një sjellje e këtillë e stafit bibliotekar ndaj lexuesit i ndihmon të gjithë jo vetëm të shfrytëzojnë në mënyrë sa më të plotë shërbimet bibliotekare, por krijon edhe raporte të afrisë, ambient të kulturuar dhe etikë të lartë profesionale dhe njerëzore.

FENOMENI

Leximi është një fenomen kompleks kulturor, arsimor dhe sociologjik. Asnjërit nga këta faktorë nuk mund t'i jepet përparësi ose të lihet me një anë në procesin e formimit të lexuesit, veçmas nëse kemi të bëjmë me lexuesin e ri. Ai, pra lexuesi që është në formim e sipër, duhet ta kuptojë se të lexuarit do të bëhet pjesë e pandashme e jetës së tij dhe se pa këtë veprim jeta e tij jo vetëm që nuk ka kuptim, por thjeshtë është e pamundur. Të krijosh një lexues të ri domethënë jo vetëm të ushtrosh ndikim të jashtëzakonshëm mbi formimin e tij kulturor dhe arsimor, por edhe të ushtrosh ndikim mbi personalitetin e tij, mbi edukatën e tij, mbi orientimin e tij jetësor.

Pa shprehinë e leximit, pra, sot nuk mund të mendohet jeta e njeriut. Edhe përkundër faktit se mundësitë për ta zëvendësuar librin me forma të tjera të marrjes së informacionit dhe të dijes janë zgjeruar së tepërmi, leximi i librit vazhdon të mbetet baza e të gjithë leximeve të tjera. Pra, libri mbetet i pazëvendësueshëm edhe në kohën e depërtimit kaq të fuqishëm të medies elektronike dhe të internetit. Kështu, frika se libri po e humb funksionin e vet parësor është treguar e paarsyeshme. Edhe ankesat e vazhdueshme se në botën bashkëkohore libri lexohet më pak se dikur, janë të paqëndrueshme. Shtimi i vazhdueshëm i sasisë së librave të botuar e tregon pikërisht të kundërtën.

Megjithatë, shoqëritë e ndryshme kanë përvoja të ndryshme sa i përket leximit. Shoqëritë në transicion, siç është edhe shoqëria kosovare, ballafaqohen me situata të pafavorshme të raportit të lexuesit me librin. Përveç mungesës së traditës, ndër faktorët kufizues të leximit hyjnë edhe mungesat e shumta kulturore, arsimore dhe veçmas ato sociale. Nga ana tjetër, shoqëria kosovare viteve të fundit ka kaluar nëpër probleme të shumta, të cilat leximin e librit dhe përgjithësisht emancipimin e kanë nxjerrë në margjinë të preokupimeve të kësaj shoqërie. Krahas kthesave të tjera të rëndësishme politike dhe shoqërore, Kosova gjatë këtyre viteve ka dështuar të fillojë një proces të qëndrueshëm dhe afatgjatë të emancipimit të përgjithshëm.

STATISTIKAT

Fenomeni i leximit te ne, njësoj sikundër edhe raporti i lexuesit me librin, nuk është trajtuar ndonjëherë në mënyrë të gjithanshme. Ne përgjithësisht ankohemi përse lexohet pak, përse libri nuk qarkullon sa duhet, përse bibliotekat nuk kanë shumë lexues etj. Pra, edhe kur bisedohet për këtë fenomen, ne jemi të prirë të merremi me pasojat dhe atë në mënyrë më shumë mediale, e më pak të bëjmë ndonjë hulumtim shkencor, sociologjik në radhë të parë, për të parë shkaqet e vërteta që e kanë kushtëzuar këtë defekt në jetën tonë shoqërore. Ne ende nuk kemi as shënime statistikore të sakta për librin. Në Kosovë ne akoma nuk dimë sa është saktësisht fondi i përgjithshëm bib-

liotekar, në mënyrë që pastaj të llogaritnim sa libra bien për kokë banori dhe këtë të dhënë pastaj ta krahasojmë me vendet e Europës dhe të rajonit. Madje, nuk kemi as shënime të sakta as për numrin e ekzemplarëve që botohen brenda vitit. Nëpër tribuna dhe diskutime të ndryshme ne ende shërbehemi me hamendje. Dhe, natyrisht, fajin ia lëmë ose traditës së varfër, ose Serbisë, madje shpesh duke manipuluar opinionin, duke mos thënë saktësisht atë që duhet: se ne kemi një traditë të varfër kulturore në përgjithësi, dhe të leximit në veçanti; se Serbia ka bërë dëme të pariparueshme në Kosovë, por duhet ta themi po ashtu se ne vetë jemi bërë pjesë e një degradimi të përgjithshëm, të cilin jo që nuk e luftojmë, por e ndihmojmë çdo ditë.

Këto statistika do të shërbenin si bazë për një aksion të përgjithshëm shoqëror dhe kulturor në drejtim të emancipimit të përgjithshëm, emancipim ky që paraqitet i domosdoshëm kur të kemi parasysh nivelin e ulët të edukimit dhe arsimimit. Sot nuk mund të ndërtohet një shoqëri bashkëkohore, demokratike, e prosperuar, pa ngritjen e shkallës së emancipimit. Edhe fenomenet negative të shoqërisë, me të cilat ballafaqohemi çdo ditë, nuk mund të çrrënjosen pa një aksion të koordinuar shoqëror, në qendër të të cilit do të ishte libri dhe leximi i tij. Nëse, ta zëmë, Gjermania që boton brenda vitit rreth 85 milionë kopje librash (pra afërsisht një libër për kokë banori për çdo vit), ankohet për shkallë të leximit dhe synon të barazohet me vendet si Britania, Suedia etj. (që kanë afro një libër e gjysmë për kokë banori në çdo vit), atëherë çfarë mund të themi ne, kur ky numër kopjesh i botuar brenda vitit nuk arrin as një çerek libri për kokë banori.

BIBLIOTEKAT SHKOLLORE

Dikur këto biblioteka kanë qenë më shumë të frekuentuara nga nxënësit. Kjo i ka pasur arsyet e veta, siç kanë qenë: mungesa e bibliotekave familjare, gjendja e rëndë sociale që ka kushtëzuar pamundësinë e pajisjes së fëmijëve me lekturë shkollore etj. Sot këto rrethana kanë ndryshuar rrënjësisht, por përsëri nuk kanë ndryshuar deri në atë shkallë, sa ta bëjnë të panevojshme ekzistimin e bibliotekave shkollore. Edhe në këtë pikë duhet bërë një dallim ndërmjet shkollave në zonat rurale dhe atyre urbane.

Në zonat rurale bibliotekat shkollore te ne do të jenë të nevojshme edhe për një kohë relativisht të gjatë. Ndërkohë, në zonat urbane funksioni i tyre do të vazhdojë të reduktohet edhe më tej.

Pyetja që shtrohet tani është: Cilët janë faktorët që ndikojnë në leximin e paktë të librit nëpër shkolla (në këtë kuadër edhe të librit nëpër biblioteka) dhe çfarë duhet të bëjmë që këto biblioteka të jenë më të frekuentuara nga fëmijët tanë?

Përveç faktorëve të përgjithshëm, disa prej të cilëve i përmendëm më sipër, në numrin e kufizuar të lexuesve të rinj ndikojnë edhe disa faktorë specifikë, të cilët janë tipikë për ambientin tonë shoqëror, kulturor dhe arsimor.

E para, gjendja jo e mirë në arsimin fillor dhe të mesëm në shkollat tona. Nuk mund të pretendohet se do të kemi lexues në bibliotekën e shkollës, nëse puna me nxënës ende vazhdon të jetë e reduktuar në mësimin elementar tradicional. Përveç ngritjes së cilësisë së mësimit, duhet pasur në mendje se shkolla e ka funksion edukativ dhe se ajo duhet të kultivojë te fëmijët shprehi pozitive, të cilat do t'i shërbejnë për tërë jetën. Këtë funksion shkolla jonë ende vazhdon të mos e kryejë me sukses të plotë.

E dyta, qëndrimi kohësisht tepër i kufizuar i fëmijëve në shkollë. Ne duhet ta tejkalojmë situatën e qëndrimit të fëmijëve në shkollat tona vetëm aq sa iu zgjasin orët e mësimit elementar. Nëse fëmijët do të kishin kushte të qëndronin në shkollë shtatë ose tetë orë në ditë, atëherë një orë lexim në bibliotekë do të hynte si pjesë e aktivitetit të tyre të rregullt, ashtu sikundër ndodhë në vendet e zhvilluara të Europës.



E treta, pajisja jo e mirë e bibliotekave me inventar. Në bibliotekën shkollore nxënësi duhet të gjejë një ambient të përshtatshëm, komod dhe atraktiv, në mënyrë që të ketë dëshirë të qëndrojë aty për një kohë më të gjatë.

E katërta, pajisja e bibliotekave shkollore me botime të reja. Fëmija nuk e bën shprehi të vizitojë bibliotekën e shkollës, nëse aty gjen vetëm libra të vjetër, kryesisht literaturë tradicionale, e cila nuk zgjon kureshtjen dhe interesimin e tij.

E pesta, bibliotekat shkollore duhet të pajisen me kompjuterë dhe me internet. Është e ditur se Kosova ka bërë një depërtim të fuqishëm në përhapjen e internetit. Në shumicën e shkollave të Kosovës tashmë është instaluar interneti, por ai kryesisht është vendosur nëpër zyrat e drejtorëve ose në kabinete të informatikës. Është e domosdoshme që bibliotekat shkollore të bëhen kënde, ku nxënësit do të kenë mundësi, përveç se të shfrytëzojnë librin, të përdorin edhe internetin.

E gjashta, kualifikimi dhe ngritja profesionale e kuadrit bibliotekar nëpër shkolla. Por kjo nuk mjafton të thuhet, sepse ne jemi në dijeni se ky kuadër nuk ka trajtim adekuat në sistemin tonë shkollor. Bibliotekarët e shkollave kanë status të keq profesional dhe social. Kjo nuk vlen vetëm për shkollat. Status të keq social kanë edhe bibliotekarët në të gjithë sistemin e bibliotekave te ne. Ata nënçmohen dhe anashkalohen. Nuk mund të kërkohet një depërtim i ri i librit në shoqëri, përfshirë këtu edhe shkollën, nëse kuadri profesional bibliotekar ka një pozitë sociale të mjerueshme dhe kategorizohet në staf civil të dorës së dytë, duke u krahasuar me rojën e natës ose me kuririn e shkollës.

NDRYSHIMET

Që të ndryshohet kjo gjendje, është e nevojshme që bashkë me konceptin e shkollës, të ndryshojë edhe koncepti i bibliotekës shkollore, e bashkë me këtë, edhe koncepti i librit dhe i lexuesit. Ky koncept duhet të pësojë ndryshime esenciale në të kuptuarit e rëndësisë që ka. Nuk mund të bëhet fjalë për një shkollë moderne, për një sistem të avancuar shkollor, duke anashkaluar idenë se libri është themel i dijes dhe shprehia e leximit është njëra nga shprehitë më dobiprurëse për njeriun bashkëkohor.

ROLI I PËRDORUESIT DHE BIBLIOTEKARIT NË RUAJTJEN E LIBRIT

TEUTA DEMIRI

Drejtoreshë e Bibliotekës
Ndërkomunale të Ferizajt

HYRJE

Duke u nisur nga rëndësia e librit dhe e ruajtjes së tij, ne jemi ata që duhet të kontribuojmë në jetëgjatësinë e tij. Letra kryesisht përbën librin, libri përmban dijen që shpërndahet në mbarë njerëzimin, por libri nënkupton edhe ruajtjen e tij. Preokupimi kryesor i një bibliotekari dhe jo vetëm i tij, patjetër se do të duhej të jetë ruajtja e koleksioneve të bibliotekës dhe pasurimi me ato që nuk janë. Ndjenja e ruajtjes së librit dhe e të lexuarit të një libri të vjetër ka vlerë plotësuese për ne, e cila para së gjithash bart një kohë tjetër me gjithë koloritin e saj. Kjo bartje e kohëve është trashëgimi e njerëzimit që shërben si përvoje dhe dëshmi

„Librat janë bërë nga materiale të llojllojshme shumica nga to janë prodhime natyrale: letra, dërrasa dhe fijet (peri) e librit - janë të gjithë përbërësit e celulozës, materie bimore. Sipërfaqja mund të jetë e gjerë, përfshirë këtu edhe prodhimet e lëkurës, tekstilit apo plastikës. Disa nga këto materiale janë të mira, kualiteti i qëndrueshëm, por ka të tjera të dobëta që shkatërrohen lehtë, sidomos ato që janë ekspozuar shumë apo janë përdorur shumë“1.

Një shkrim që e përdora nga interneti, tregon në mënyrë shumë praktike se si mund ta përdorim librin, duke mos e dëmtuar, sepse edhe libri është i ndjeshëm si qeniet e gjalla. Këtë leksion shumë të thjeshtë është mirë ndoshta ta vendosim edhe në muret e bibliotekave, në mënyrë që në një masë të ndikojmë në krijimin e vetëdijes së lexuesit për ruajtjen e librit. Ja sa në mënyrë të thjeshtë dhe praktike paraqitet:

„Në vend të thyerjes se faqes poshtë apo lartë, përdorni një shënues. Thyerja e letrës poshtë mund të shkaktojë irritim te përdoruesi. Mos përdorni ngjitës shënime sepse ato janë të tepërta në letër. Ushqimi dhe pijet larg nga librat. Mos të hapet libri përtej hapjes së saj natyrore.“2

Po ashtu, siç ceket edhe në Udhëzimet e IFLA-s, lexuesit duhet njoftuar që mos të pinë, të hanë apo tymosin duhan, të mos prekin materialet bibliotekare me duar të papastra, të mos përdorin ngjyrë stilolapsi, lëndë korrektimi apo nënvizimi etj. Nga ky aspekt lexuesit duhet njoftuar mbi mirëmbajtjen e materialit bibliotekar, përdorimin e tij, si duhet marrë dhe kthyer libri, dhe rëndësinë e materialit se sa është i vlefshëm.

Për të shtuar mundësitë e ruajtjes së librit, duhet shtuar edhe mundësitë e informimit më të plotë për librin; është mirë që pikërisht në aktin e furnizimit të bibliotekave me libra dhe materiale të tjera shkrimi, të bëhen shpjegime rreth asaj se me çka po furnizohet biblioteka, dhe pos që informohet se për çfarë zhanri bëhet fjalë në atë libër, është mirë të shtohet edhe informata se çfarë materiali ambalazhues kanë, veçoritë, a janë të përcjella me ndonjë nga defektet apo dëmtimet, dhe se në çfarë kushtesh duhet mbijetuar ato.

Kur një bibliotekë furnizohet me material bibliotekar duhet të jenë parasysh disa kritere apo edhe problememe që mund të ketë gjatë botimit të tyre. Këto të dhëna më pastaj lehtësojnë punën e konservimit dhe restaurimit.

Rasti më eklatant që kam hasur gjatë punës në bibliotekë e që më pastaj jam informuar që nuk janë aq të rralla këto raste, është kur lexuesi merr librin në sallën për lexim dhe meqë libri nuk lejohet të dal jashtë objektit, ai gris disa faqe, i fsheh në trup dhe ik.

Ky dëmtim i librit është i pafalshëm por është vështirë të përcillet çdo lexues dhe të shfletohet çdo libër para dhe pas përdorimit. Kur gjithë kësaj i shtohet fakti se zakonisht koleksionet janë shume të shtrenjta dhe është e vështire për t'u zëvendësuar, natyrisht dhembja për librin bëhet më e madhe. Por nuk duhet ngelur vetëm në nivelin e dhembjes, por bibliotekat duhet të kenë rregulla strikte, së paku për librat e veçantë, që të mos nxirren jashtë bibliotekës, dhe kujdesi ndaj librit të rritet akoma dhe ky kujdes të bartet te shfrytëzuesit e bibliotekës. Kujdesi për një koleksion bibliotekar është një çështje e gjerë. Secila bibliotekë pa marr parasysh madhësinë, duhet të zgjedhë si do të kujdeset për koleksionin e saj. Riparimi i suksesshëm i librit është një komponent i rëndësishme e zhvillimit të koleksionit dhe programit të mirëmbajtjes.

Më e mira do të ishte preventiva dhe kujdesi ndaj librit kur ende nuk është dëmtuar në masën e rrezikimit. In case of absolute loss of a leaf or a part of a page, there are only three remedies known to me.Në rast të humbjes së një fletë ose një pjesë të një faqe, The book may be condemned as imperfect, and a new copy

purchased. libri konsiderohet si i paplotë, dhe për të eliminuar këtë gjë, pjesa e munguar mund të fotokopjohet nga një kopje tjetër, duke e vendosur kopjen në vendin përkatës, ose mund të bëhet edhe me stilolaps me shkrim në mënyrë që libri të bëhet i plotë, sepse pikërisht në faqet e grisura apo të humbura, mund të jetë një informatë shumë e rëndësishme.

Intervenim që bëhet në çdo lloj dokumenti për të kthyer sa me afër gjendjes së origjinalit është procesi i restaurimit:

- A është dëmtuar nga pakujdesia apo thjesht nga përdorimi?
- A është fabrikuar në atë mënyre që është shkaktuar dëmtimi?
- A ka dështuar një riparim i mëhershëm apo dhe ka shkaktuar më shumë dëmtime?
- Sa e ka vështirësuar riparimi mekanikën (mënyrën sesi hapet dhe mbyllet libri, si shfletohen fletat e librit?

Po ashtu rol të veçantë në ruajtjen e koleksioneve të bibliotekës ka vetë biblioteka ku mbahet dhe shfrytëzohet materiali. Natyrisht shtëpitë botuese do të duhej që librat shkencorë dhe të autorëve të promovuar, t'i botojë me lidhje të fortë dhe me letër të kualitetit të lartë dhe sa më të rezistueshëm ndaj faktorëve të dëmtimit, krahas kësaj edhe bibliotekat librat e tillë me vlerë të veçantë duhet ruajtur në hapësira më të mbrojtura dhe më të sigurta nga fatkeqësitë që mund t'i vijnë librit. Ruajtja e materialit bibliotekar edhe në anën ekonomike ka rolin e saj, pasi që zëvendësimi i tij është shumë i shtrenjtë.

Stafi i bibliotekës duhet të jete ai që shfrytëzuesit e ardhshëm t'i shërbejë me koleksione, duke i ruajtur materialet me të cilat punojnë me përkushtim dhe përkujdesje maksimale. Ajo që është krijuar nëpër shekuj, pra koleksionet e bibliotekave, të ruhen së paku aq sa është e mundur, duke aplikuar metodat që kanë të bëjnë me librat - pra nga materiali letër dhe materialet e tjera përmes konservimit dhe restaurimit të tyre. Hulumtimet na bëjnë me dije se konservimi dhe restaurimi ka një histori të gjatë dhe një qasje tjetër nga ne, që duhet doemos ta marrim si një leksion dhe ta aplikojmë në bibliotekat tona, duke bashkëpunuar me vendet që kanë krijuar një traditë dhe që posedojnë stafin dhe format më të reja të restaurimit dhe konservimit.

Referenca:

- URL:http://www.conservation-register.com/booksbibles.asp?id=4 (2009.02.24)
- URL:http:// www.philobiblon.com-/pressite.html (2009.02.28)

HISTORIKU I BIBLIOTEKAVE UNIVERSITARE NË KOSOVË

TAHIR FONIQI

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Bibliotekat universitare përbëjnë një tip të veçantë të bibliotekave, të cilat veprojnë brenda shkollave të larta e fakulteteve. Ato janë biblioteka shkencore të karakterit special e të përgjithshëm. I quajnë edhe biblioteka akademike, ngase kontribuojnë në arritjen e titujve akademikë e në arsimimin akademik. Detyra kryesore e bibliotekave universitare shihet në kontributin e tyre në zhvillimin e shkencës e të arsimit të lartë dhe në zgjerimin e njohurive, që lidhen ngushtë me detyrat dhe funksionet e secilit universitet".

RRJETI DHE ASPEKTE TË TJERA TË KËTYRE BIBLIOTEKAVE

Rrjeti i bibliotekave universitare është formuar mes viteve 1958-1981, krahas formimit e zhvillimit të shkollimit të lartë. Ky rrjet fillon më 1958, me formimin e bibliotekës së Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në fillim të punës kjo bibliotekë ka pasur 15000 ekzemplarë librash. Kështu që, për një student, kanë rënë mbi 100 libra. Më 1965 ky fond arrin në 20000 libra.

Më 1960, fillojnë të hapen edhe bibliotekat e para të fakulteteve, të ashtuquajtura bibliotekat seminarike. Ato formohen brenda grupeve: Gjuhë dhe Letërsi Serbokroate, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Kimi dhe Biologji, me fondin e përgjithshëm të librave 901 kopje. Meritën kryesore, për formonin e këtyre bibliotekave, e kanë Dr. Idriz Ajeti dhe Dr. Dervish Rozhaja.

Më 1986 ishin 28 biblioteka universitare: gjashtë të shkollave të larta e 22 të fakulteteve: në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan e Ferizaj.

Disa biblioteka universitare janë formuar duke trashëguar fonde nga bibliotekat pararendëse. Kështu, biblioteka e Fakultetit Juridik dhe ajo e Fakultetit Ekonomik e kanë nismën nga fondet e bibliotekës së Shkollës së Lartë Juridike në Prishtinë, e cila ka pushuar më 1962. Biblioteka e Fakultetit Teknik ka trashëguar koleksionet e bibliotekës së Shkollës së Lartë Teknike, ajo e Fakultetit të Bujqësisë trashëgon fondet e ish-bibliotekës së Shkollës së Lartë të Bujqësisë, biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë ka trashëguar fonde librash nga biblioteka e Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë e cila dikur ka qenë mjaft e pasur.

Në mbarim të vitit 1986, bibliotekat universitare, kanë pasur 267051 ekzemplarë: 102412 ekzemplarë - bibliotekat e shkollave të larta dhe 164639 ekzemplarë ato të fakulteteve. Bibliotekat kishin edhe 1256 tituj të periodikut: 229 - bibliotekat e shkollave të larta dhe - 1027, ato të fakulteteve. Këto fonde janë siguruar përmes blerjes e dhuratave.

Disa biblioteka, qysh me rastin e formimit, kishin fonde të mirë librash. Fjala vjen biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë ka pasur 20000 ekzemplarë, ajo e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë 15000 ekzemplarë etj.

Në mbarim të vitit 1986 bibliotekat kanë pasur 43726 përdorues: 4487 - bibliotekat e shkollave të larta e 39239 - të fakulteteve.

Fondi fillestar i bibliotekës universitare duhet të jetë 10000 ekzemplarë librash, përkatësisht 200 tituj të periodikut, me përtëritje 3 ekzemplar libri për studentë gjatë një viti.

Gjatë përtëritjes së koleksioneve të bibliotekave universitare duhet të kihet parasysh, që literatura të përmbajë vlera të qëndrueshme shkencore, arsimore, kulturore, artistike etj., si: enciklopedi të përgjithshme e speciale, bibliografi speciale, fjalorë profesionalë, vepra shkencore, letrare e artistike të klasikëve botërorë, inkonabula, libra të vjetër e të rrallë e doreshkrime, mjete audiovizuele etj..

Gjatë vitit 1986 përdoruesit kanë përdorur 121024 libra: 9334 - bibliotekat e shkollave të larta dhe - 111690 ato të fakulteteve. Secili përdorues ka lexues mesatarisht nga 2,77 libra.

Po ashtu bibliotekat kanë pasur 49 lokale bibliotekare: 13 - bibliotekat e shkollave të larta e 36 -

ato të fakulteteve, përkatësisht 26 salla të leximit: 7 bibliotekat e shkollave të larta e 19 ato të fakulteteve. Bibliotekat e fakulteteve kishin 2050 vende për lexim. Sipas një standardi, parashihet 1 vend për 9 studentë.

STAFI BIBLIOTEKAR DHE RREGULLIMI PROFESIONAL I BIBLIOTEKAVE

Më 1986 bibliotekat universitare kanë pasur 40 punëtorë bibliotekarë: 35 të përhershëm ose 87.5 për qind dhe 5 me honorar ose 12.5 për qind. Përgatitja shkollore e kuadrit bibliotekar ishte: 15 me fakultet ose 37.5 për qind, 7 me shkollë të lartë ose 17.5 për qind e 18 me shkollë të mesme ose 45 për qind. Kuadri me fakultet ka punuar në bibliotekën e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prizren, bibliotekat e Fakultetit të Filozofisë, të Fakultetit të Shkencave Natyrore Matematikore, Fakultetit Teknik, Fakultetit të Arteve, Fakultetit të Bujqësisë dhe në bibliotekën e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë. Vetëm katër veta kishin të kryer provimin profesional të bibliotekarisë. Për më tepër, sot e kësaj dite, në Kosovë, nuk ekziston ndonjë shkollë e lartë apo fakultet, që përgatit kuadro me shkollim adekuat për veprimtarinë bibliotekare.

Rregullimi profesional i koleksioneve të bibliotekave universitare nuk është bërë krahas formimit të rrjetit të tyre. Këto biblioteka kanë funksionuar ekskluzivisht si servise të specializuara e të pavarura të procesit mësimor-shkencor brenda institucioneve shkollore superiore, të cilat edhe i kanë themeluar. Në të vërtetë organet e fakultetit i trajtonin si njësi teknike-administrative.

Në mbarim të vitit 1986 bibliotekat universitare (të shkollave të larta e të fakulteteve) kanë pasur në përdorim 17 skedarë: 12 me bazë alfabetike e 5 lëndorë. Kështu që, 12 biblioteka universitare nuk kanë pasur skedarë në përdorim, shprehur në përqindje - 42.8 për qind. Dihet se skedarët janë instrumenti themelor informues për përdoruesit e koleksioneve të bibliotekës dhe pasqyrë e rregullimit profesional të koleksioneve. Ata i quajnë edhe truri i bibliotekës. Shumë biblioteka nuk kanë fare skedarë. Rrjedhimisht bibliotekat mezi e kryejnë funksionin e tyre bibliotekar për çka edhe janë themeluar.

Depotizimi i materialeve bibliotekare, në këtë tip të bibliotekave, rëndom, bëhet sipas numerus currens-sit (radhës së hyrjes të materialit bibliotekar në bibliotekë) e KUD-it apo lëndës.

Raportet e nxjerra për gjendjen e bibliotekave universitare në Kosovë, nuk jep tash për tash kurajën për modernizimin e shpejtë të tyre. Ato ende punojnë brenda kornizave tradicionale, duke u trajtuar si depo për huazimin e librave dhe të revistave. Shumë biblioteka nuk kanë rregullore të punës e nuk figurojnë as në statutet e fakulteteve.

Me trajtimin e këtillë, këto biblioteka, nuk mund të bëhen baza shkencore-mësimore dhe qendra bibliotekare-informative brenda institucioneve arsimore, ku veprojnë aktualisht.

ROLI DHE POZITA E BIBLIOTEKËS NË REALITETIN E RI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

MR. SC. HAJRULLAH MUSTAFA

Koordinator
(Biblioteka Ndërkomunale "Latif Berisha" - Mitrovicë)

Tendencat më aktuale sot në botën bashkëkohore, prandaj edhe në Republikën e Kosovës, janë të fokusuara për sigurinë në një rend të ri botëror me objektivat, si: nxitja e paqes, demkracisë, të drejtave të njeriut, zhdukja e varfërisë, etj., me fjalë të tjera kah procesi i globalizimit politik dhe juridik, pasi që shtetet gjithnjë e më shumë lidhen së bashku me një bashkëpunim politik të detyruar, në shumë sfera të jetës.

Bashkësia ndërkombëtare gjithherë po bëhet më e hapur për shumë shtete, duke kooperuar dhe bashkëpunuar. Pothuajse asnjë shtet sot, nuk mund të jetojë i ndarë nga të tjerët. Largësitë mes shteteve janë duke u shkurtuar. Shumë njerëz sot lëvizin nga një vend në tjetrin, dhe kufijtë shtetëror sa vijnë e bëhen më pak të rëndësishëm për tregtinë dhe veprimtaritë ekonomike. Edhe teknologjia moderne informative është duke lidhur dhe integruar botën. Këtë proces ku po thyhen kufijtë e vendeve dhe po lidhet bota së bashku e quajmë globalizim.

Prandaj, në këtë realitet, informacioni paraqet rolin udhëheqës, sepse komunikimi në mes njerëzve realizohet përmes pranimit dhe përcjelljes së lirë të informacionit, pa marrë parasysh pengesat politike ose pengesat e natyrave të tjera.

Pra e drejta themelore e çdo njeriu është qasja e lirë në informacion, ndërsa baza për funksionimin e një shoqërie demokratike është e drejta e çdo qytetari të kërkojë dhe pranojë informacionet pa kufizime nga të gjitha sferat e jetës, d.m.th. të jetë i lirë. E për me qenë i lirë, ai duhet të jetë i informuar mirë. Pikërisht për këtë, e drejta për informacionin e me këtë edhe e drejta për dituri, nuk mund të konsiderohet vetëm nevojë individuale por edhe nevojë e çdo shoqërie dhe e çdo administrate shtetërore të avancuar.

Pa dyshim se obligimi dhe përgjegjësia më e madhe në qasjen e informacioneve bie mbi bibliotekat, e posaçërisht të vendeve të cilat kaluan përmes tranzicionit dhe implementojnë sistem demokratik shoqëror. Në këtë grup bën pjesë edhe Republika e Kosovës.

Prandaj, realiteti i ri kërkon ndryshim qasje dhe pozicion tjetër të bibliotekës, karshi kuptimit tradicional që kishte dikur biblioteka. Përveç kësaj, praktikën e gjertanishme të bibliotekave publike në Kosovë e kanë përcjellë shumë pengesa e vështirësi siç janë: hapësirat e vogla dhe joefikase për veprim, mungesa e pajisjeve, pasurimi i vogël i fondeve me koleksione, problemet financiare, etj.

Megjithatë punonjësit e bibliotekave asnjëherë nuk u gjunjëzuan edhe në realitetin paraluftës në Kosovë, por qëndruan në realizmin e misionit të tyre, për zhvillim dhe afirmim të kulturës në përgjithësi, dhe kulturës së të lexuarit në veçanti. Është rast shumë i veçantë, koha kur libri shqip ishte halë në sy për pushtetin serb të instaluar në atë kohë në Kosovë, vendosmëria e punonjësve të Bibliotekës publike të Mitrovicës, në bashkëpunim me Kryesinë e LDK-së, përkatësisht, Komisionin për Kulturë të asaj kohe begatoi bibliotekën me fond të mrekullueshëm të librit shqip në vitin 1997, që argumenton qartë se sa të përkushtuar ishin bibliotekarët në misionin e tyre.

Shumë nga këto biblioteka u shkatërruan nga lufta, e riaktivizimi i tyre po ec me shumë vështirësi.

Ndonëse në realitetin pas lufte, marrë në përgjithësi në Kosovë janë duke u bërë ndryshime pozitive, mendoj se prapë se prapë gjendemi larg objektivave dhe funksioneve që kanë bibliotekat moderne.

Ndryshimet e mëdha dhe shumë të thella në zhvillimin shoqëror që u bënë në dekadat e fundit të shekullit të kaluar dhe fillimin e shekullit të ri, në të gjitha sferat e jetës shoqërore, nuk mund t'i ikin as bibliotekat si institucione shumë të rëndësishme, edukative, kulturore dhe informative, sepse duhet të përcjellin të gjitha këto ndryshime duke u bërë edhe vetë pjesë integrale e këtyre të arriturave.

Faza e fillimit të modernizimit të bibliotekave në shumë vende të botës, që ka filluar kah vitet shtatëdhjeta të shekullit XX, obligon qasje të re ndaj bibliotekave në të gjitha dimensionet e saja.

Këto rrjedha shtrojnë nevojën që edhe para institucioneve të Kosovës të afirmojnë tretman dhe qasje të re, për shkak të:

Zhvillimit historik me pengesa dhe sfida në të cilat ka kaluar Kosova;

Zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së informacionit që mundëson sasi të madhe informacioni për të gjithë ata që kanë dëshirë e nevojë që të kanë akses në botën e informacionit;

Për rolin që kanë bibliotekat, në deklaratën për Bibliotekat dhe Lirinë Intelektuale, miratuar nga kryesia e IFLA-s më 25 mars 1999, Hagë, Holandë, thuhet se shërbejnë si porta të diturisë, mendimit dhe kulturës.

Për të arritur këtë, duhet elaboruar dhe analizuar fillimisht pozicionin e bibliotekave publike në rrafshin e realitetit momental në Kosovë, me të vetmin qëllim që të bëhemi pjesë e bibliotekave moderne dhe të avancuara bashkëkohore. Hapat konkret, sipas mendimit tim, do të ishin qasjet dhe tretmani shumë më i madh dhe shumë më frytdhënës i institucioneve të Republikës së Kosovës ndaj bibliotekave publike, dhe atë duke filluar nga:

Hapësirat e bibliotekave, të cilat jo si deri tani të adaptuara për shërbime bibliotekare, por të projektuara pikërisht për veprimtarinë e bibliotekës publike që reflekton funksionalitet dhe akses të lehtë për të gjithë përdoruesit, duke mos harruar edhe një sërë shërbimesh jashtë mureve të bibliotekës;

Ngritja dhe avancimi i fondeve me koleksione shumë më të avancuara dhe më aktuale dhe konform kërkesave dhe nevojave të përdoruesve. Kjo do të arrihej kur bibliotekat kanë burimet primare dhe të sigurta të buxhetit, e jo të pritet që ripërtëritja e fondeve të realizohet vetëm me burime sekondare e shpesh herë të pasigurta;

Ngritje permanente e kuadrit bibliotekar, pasi që personeli është burimi më i rëndësishëm në veprimtarinë e bibliotekës. Dinamika e shpejtë e zhvillimit të teknologjisë informative, kërkon personel profesional, të shkolluar dhe të trajnuar, sepse vetëm kështu realizohet përdorimi efektiv i të gjitha burimeve që ofron biblioteka. Duhet të tejkalohet bindja së në biblioteka mund të punojë çdokush dhe gjithkush. Ndërsa vonesa e hapjes së katedrës për kuadro të bibliotekave në Universitetin e Kosovës është e pajustifikueshme;

Aplikimi i programit të digjitalizimit të shërbimeve bibliotekare në tërë sistemin bibliotekar të Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt janë bërë hapat e parë, është pranuar programi, por vetëm duhet shtrirje në tërë sistemin e bibliotekave publike;

Tani është nevojë e nxitjes dhe afirmimit të një veprimtarie bibliotekare kërkimore – hulumtuese, e cila padyshim se do të ndihmojë, ndër të tjera edhe identifikimin dhe plotësimin e kërkesave të përdorueseve, por edhe do të ndikonte në edukimin e tyre për qasje më të shpejtë dhe më praktike në informacione;

Afirmimi i formave të ndryshme të bashkëpunimit të bibliotekave publike të Kosovës me ato të vendeve më të përparuara perëndimore më tepër se deri tani, është nevojshme. Nëpërmjet këmbimit të ekspertëve dhe trajnimeve, do të aplikonim afirmimin e praktikave të avancuara bibliotekare, dhe, me siguri, do të ndihmonin edhe implementimin e tyre në realitetin e Kosovës.

Një trajtim dhe qasje më e përgjegjshme e institucioneve të Republikës së Kosovës ndaj bibliotekave, do të hapte rrugë për ngritjen dhe funksionimin e suksesshëm të bibliotekave të Kosovës dhe do të krijonte mundësi që bibliotekat të përcjellin gjithë rrjedhat dhe dinamikat e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë, ashtu si funksionojnë sot bibliotekat moderne në shumë vende të botës.

FONDI I SEKTORIT TË VENDLINDJES NË BIBLIOTEKAT PUBLIKE

PREND BUZHALA,

Drejtor i Bibliotekës Komunale të Klinës

Le ta përfytyrojmë për një çast botën pa biblioteka, ashtu sikundër i ndodhi bibliotekës së Aleksandrisë: bota do të mbetej përnjëmend pa kujtesën e saj e pa shkallën e dijes që ka arritur. Nocioni bibliotekë publike ka origjinë anglosaksone (public library). Së këndejmi, gjatë shekujve të fundit, në shtetet e Evropës perëndimore e në SHBA, nëpër bibliotekat publike janë themeluar edhe Fondet e Sektorëve të Vendlindjes apo Koleksionet Lokale. E kjo do të thotë që një komb a një mes është i interesuar për të vërtetën e së kaluarës së vet, për trashëgiminë materiale e shpirtërore të veten. Dhe vërtet, nëse biblioteka publike, e nivelit më të vogël lokal, e niveleve komunale apo ndërkomunale, është, ndër të tjera, edhe shenjë e zhvillimit të përgjithshëm të atij mesi, atëherë shtrohet edhe pyetja: a ka ndër ne ndonjë mes të tillë që nuk dëshiron të interesohet për të kaluarën e vet, që nuk brengoset për zhvillimin e potencialeve të qytetarëve të vet dhe që shfaq qëndrimin e vet armiqësor ndaj lirisë së shprehjes? Piter Bofi në librin e tij "Biblioteka në shekullin XXI" thotë: "Kombet e tilla nuk kanë nevojë për biblioteka".

Të përkujtojmë, se edhe në Kosovë, ani se nën shtypjen e regjimit serbo-jugosllav, kanë ekzistuar atykëtu edhe sektorët e tillë. Porse ata sektorë kanë qenë nën mbikëqyrjen tejet të rreptë të eksponentëve të regjimit, ku është mënjanuare e dënuar shumëçka që ka qenë, sikundër thuhej atëherë, me përmbajtje nacionaliste apo armiqësore. Veprohej kështu, sepse ishte qëndrim politik që shqiptarët të goditeshin sa më shumë në kujtesën vet nacionale. A nuk u zhduk një pjesë e kujtesës sonë nacionale me rastin e djegies së Akademisë së Voskopojës dy herë nga sunduesi turk, më të egrin që ka njohur historia këndej; a i zhdukjes së dëshmive e shkrimeve tjera nëpër qendrat e kulturës sonë anekënd trojeve etnike? Përfytyroni ato miliona ekzemplarë të djegies së bibliotekave shtëpiake, shkollore a publike nga agresioni serb gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kujtesa e literaturës vjen në kohën tonë: Shën Hieronimi ilir mbahet si patron (shenjtor, mbrojtës, pajtor) botëror edhe i bibliotekave e librarëve, edhe përkthyesve. Bibliotekat evropiane të manastireve, koleksionet private anekënd Evropës, bibliotekat mbretërore, bibliotekat e muzeve ...e deri tek bibliotekat nacionale, publike, ato universitare, shkollore, apo bibliotekat e vendeve të punës, të themeluara në shekujt modernë, si dikur, si sot: e ruajnë të shënuar kujtesën e njerëzimit. Ndryshe, nuk do të ishte gjetur libri i Buzukut a librat tjerë. Që nga Buzuku e këndej, klerikët e ditur, aty ku hapnin një tempull fetar, aty krijonin një bibliotekë e mandej edhe një shkollë.

Fondin e Koleksionit të vendlindjes e përbëjnë librat, gazeta, revistat, materialet e tjera të shtypura, si dhe materialet e tjera që ngërthejnë burime informacionesh për mesin përkatës komunal a lokal; për të kaluarën historike të atij mesi, që kanë informacione e materiale për njohjen e atij mesi, për veçoritë natyrore e gjeografike, për pikat turistike, që kanë shënime e burime literature për banorët, për kubaturën, për ekonominë, bujqësinë, apo për personalitetet e atij mesi. Është pikërisht ky sektor që paraqet bazën më të rëndësishme e më të përshtatshme të të dhënave për mesin lokal, që paraqet lidhjen tejet të rëndësishme për atë rajon a mes. Madje, secili artikull gazete, fotografi, punim magjistrature, tezë doktorate, qoftë edhe një afishe, shpallje, katalog, dorëshkrim, hartë gjeografike, listë nxënësish, akt zyrtar, thirrje, pllakë gramafoni, radio të tipave të vjetër, lëndë e incizuar muzikore etj. etj., mund të shërbejnë për të dhëna interesante e të dobishme. Fondi i tillë themelohet me veprimet e përbashkëta e në bashkëpunim me institucionet, me arkivat, në bashkëpunim me qytetarët, me njerëz të dijes, të shkencës e të jetës publik. Po ashtu, edhe hulumtimi i materialeve nëpër shtypshkronja, hulumtimi i bibliografive, sigurimi i publikimeve të reja që kanë të bëjnë me atë mes, i revistave e i gazetave lokale, i lëndës audio-vizuale, është me interes për këtë fond. Aty hyjnë edhe furnizimi me materiale monografish, koleksionet në formë dhuratash, pasuri e lënë me testament (sikundër janë bibliotekat personale a familjare), dhurata veprash artistike të krijuesve figurativë, dhurata të koleksioneve të gazetave apo revistave etj. në meset ku në të kaluarën ka pasur shtypshkronja,

ato shërbejnë si bazë e mirë për burime informatash për mesin e caktuar. Pajisja me fotokopjues skanerë etj., i shërben këtij Fondi për fotokopjime e skanime materialesh, fotografish apo të lëndës së ngjashme për ta pasuruar këtë fond.

Së këndejmi, Fondet e tilla të sektorëve të vendlindjes do të shërbenin si burime të fondit nacional për meset përkatëse, si

Ky fond përfshin edhe librat e moçëm e të rrallë apo dorëshkrimet e rralla e me vlerë për atë mes.

Prandaj, sektori i tillë përfshin qindra e mijëra njësi bibliotekare.

Ata sektorë themelohen sipas kritereve tematike, autoriale, apo botuese dhe sipas lëndës e materialeve jolibrare. Fondi i tillë, është e qartë, se iu shërben nxënësve, studentëve, profesorëve, shkencëtarëve, gazetarëve lokalë, mediave lokale,

Krijimtaria e personaliteteve të dalluara të jetës kulturore, letrare artistike apo të jetës publike, përbën një thesar tjetër të këtij fondi.

Ndërkaq, bibliotekat e tilla publike, komunale apo rajonale, po qe se kanë arritur të hyjnë në proceset e transformimit e të zhvillimit në biblioteka elektronike moderne, mund të hapin edhe uebfaqet e tyre të këtij sektori. Zaten, në internet ka



dhe për ta studiuar e për të mësuar për kubaturën materiale e shpirtërore të atij mesi.

Do theksuar se një Fond i tillë e mbulon hapësirën përkatëse që e mbulon ajo bibliotekë: bie fjala, një bibliotekë publike komunale e merr përsipër themelimin e sektorit të tillë për tërë hapësirën komunale, kurse dega e një biblioteke në një qendër lokale të një bashkësie lokale, mund ta marrë përsipër hapësirën e pesë-gjashtë vendbanimeve të atij mesi. Prandaj, vlera kulturo-historike, shkencore e dokumentare e sektorëve të tillë është e një rëndësie të madhe dhe përdoret e shfrytëzohet ekskluzivisht në hapësirat e sallave të leximit apo të studimit.

sepse fondi i tillë për ta paraqet një burim të jashtëzakonshëm të dhënash për atë rajon, pikërisht për shkak të spektrit të gjerë të fushave që ai sektor i përfshin.

Koleksionet: koleksionet e monografive, koleksionet e publikimeve serike, koleksionet jolibrare të materialeve bibliotekare, koleksionet e dorëshkrimeve, koleksionet e, bie fjala, materialeve të seancave të asambleve komunale, koleksione mirënjohjesh, diplomash, apo e dokumentacioneve të tjera publike.

Për Fondin e tillë janë me vlerë edhe burimet për koleksionet etnografike, kurse një bashkëpunim me vlerë në këtë drejtim përbën ai me etnografët, folkloristët, rapsodët etj.

mjaft këso burime informacioni me interes për të gjithë. Madje, e dizajnuar dhe e organizuar nga zyrtarë e punonjës të bibliotekave të tilla, puna në uebfaqe është më e lehtë për tubimin e të dhënave të tilla.

Fondi i Sektorit të vendlindjes e kryen funksionin e sistemit informativ dhe krijon mundësi për punë hulumtuese, për të ditur për të gjitha sferat e fushat e jetës, zhvillimit dhe krijimtarisë së atij mesi; për të përcjellë të arriturat e atij mesi, planifikimet afatgjata të mesit përkatës, organizimin e ekspozitave, jubileve, dhe të manifestimeve të tjera me interes, përpunimin e monografive, përpunimin e bibliografive të vendlindjes, për popullarizimin e vendlindjes a komunës.

BIBLIOTEKAT SHKOLLORE NË KOSOVË - DIALOGU DHE PERSPEKTIVAT

RAMIZE BAJRAKTARI

Kosova, tashmë dhjetë vjet pas luftës, është hyrë në një konsolidim të zhvillimit e të avancimit të institucioneve arsimore. Janë rinovuar shumë shkolla, të cilat ishin shkatërruar apo djegur nga forcat serbe, gjatë luftës së fundit, si dhe janë ndërtuar edhe shumë shkolla të reja. Të gjitha këto institucione shkollore, janë në përpjekje për të krijuar kushte, duke garantuar hapësira të mjaftueshme dhe mjete shkollore në përputhje me standardet për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Në këtë konsolidim të institucione shkollore, vend të veçantë zë krijimi i hapësirave edhe për bibliotekat shkollore dhe pajisja e tyre me koleksione, qasje në internet, si dhe me kushte për lexim, përkatësisht për përdorim të koleksioneve brenda këtyre bibliotekave.

Që këto biblioteka të nisin punën, ose të realizojnë funksionin e tyre, nëse ato tashme ekzistojnë, duhet fillimisht, pos përkrahjes nëpërmjet një buxheti të veçantë për to, para se gjithash të kenë të hartuara politika për pasurimin dhe zhvillimin e koleksioneve, përpunimin e tyre, radhitjen në rafte, si dhe qarkullimin e këtyre koleksioneve. Që të arrihen këto kritere, apo thënë më troç që të funksionojë një bibliotekë shkollore, duhet të ketë një staf bibliotekar që njeh, kupton dh zbaton, së paku, disa nga standardet elementare të pasurimit, përpunimit dhe qarkullimit të koleksioneve.

Dihet që shumica e bibliotekave shkollore kanë hapësira të vogla dhe joefikase për vendosjen e fondeve, por edhe të kushteve për lexim, kanë mungesë të fondeve, duke mos u pasuruar me tituj të rinj me vite, fonde të papërpunuara, mungesë të politikave të qarta të qarkullimit, mungesë të stafit që mund të aplikojë standardet ndërkombëtare të përpunimit të koleksioneve etj.

Duke pasur parasysh, se në një situatë çfarë gjenden shkollat dhe stafi i tyre në Kosovë, të rrallë ose fare mund jenë shembujt ku një shkollë t'i ketë të plotësuar kushtet e një biblioteke. Ky fakt do të duhej të motivonte hapjen sa më shpejt të një dialogu permanent të institucioneve bibliotekare - Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, si qendër e arsimimit dhe zhvillimit të bibliotekave, bibliotekave ndërkomunale, bibliotekave komunale, si institucione që mbikëqyrin tipat e tjerë të bibliotekave në njësi komunash, që të hartojnë projekte dhe të modelojnë përgjegjësi për t'i ndihmuar bibliotekat ekzistuese të shkollave, si dhe për të krijuar mundësitë për formimin e bibliotekave të tjera në shkollat ku ekzistojnë kushte. Kjo do të hapte mundësinë e krijimit të një rrjeti efektiv të bibliotekave shkollore, të cilat kanë një rol të veçantë për zhvillimin arsimor dhe kulturor të nxënësve të të gjitha niveleve të shkollimit.

Ky partneritet dhe rrjet funksional i bibliotekave, do të sensibilizonte edhe institucionet e larta qeveritare dhe ato komunale për të përkrahur bibliotekat shkollore. Thënë me shkoqur, nëpërmjet iniciativave që do të vijnë nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe bibliotekat ndërkomunale dhe komunale, do të afirmohej rëndësia që

kanë bibliotekat shkollore dhe do të kihej kujdes për zhvillimin e tyre, duke investuar në to - jo si harxhime koti, po si investime që garantojnë ngritjen e cilësisë në arsim.

Deri më tash nuk është krijuar ndonjë strategji kombëtare për zhvillimin e bibliotekave shkollore. Mbështetja e institucioneve për bibliotekat shkollore nuk është e kënaqshme, ndërsa që ka, po ashtu, edhe mungesë të stafit bibliotekar, të arsimuar apo të trajnuar në fushë të bibliotekarisë.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është në fazën e hartimit të projekteve, prej nga do të burojnë nismat e saj, por edhe kërkesat praktike për institucionet qendrore dhe ato të pushtetin lokal për të investuar në krijimin e kushteve për bibliotekat shkollore. Në këtë kontekst, kërkohet të jetë në dijeninë dhe përgjegjësinë udhëheqësit të një shkolle që të hartojë së paku një projekt-skicë, prej nga del nisma dhe artikulohen nevojat dhe kushtet që plotëson një shkollë për zhvillimin apo themelimin e një biblioteke shkollore. Pra, kjo projekt-skicë do të duhej të përfshijë një informacion elementar që lidhet me hapësirën e bibliotekës, kushtet e infrastrukturës, gjendjen e fondeve, përpunimin e tyre, nivelin arsimor të stafit që punon ose do të punojë në bibliotekë etj., në mënyrë që të mund të përcaktohet se çfarë mund të ndihmohet për të vënë në funksion akëcilin bibliotekë.

Dihet se zhvillimi i bibliotekave po kalon nëpër një fazë të shpejtë transformimi, prandaj duhet të hulumtohen mirë gjithë mundësitë që të realizohen suksesshëm projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin apo themelimin e bibliotekave shkollore; që ato të plotësojnë nevojat e nxënësve dhe mësimdhënësve, të cilat burojnë nga plani dhe programi i shkollave. Ne të gjithë e dimë që një proces i mirë mësimor dhe një përgatitje e mirë e nxënësve nuk mund të realizohet pa një bibliotekë të organizuar dhe funksionale, fondet e të cilës lidhen me planet dhe programet shkollore.

Është e vërtetë se për këto dhjetë vjet Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Bibliotekat ndërkomunale dhe ato komunale kanë marrë dhe dhënë informacion, kanë zhvilluar diskutime, kanë hapur debate - por, është e vërtetë, se nga këto diskutime e debate, nuk janë ndërtuar platforma veprimi të veçanta dhe të qarta për bibliotekat shkollore. Pra, në këtë shkëmbim të informacionit e të përvojave, jemi ndalur pak për të analizuar se cilat janë kapacitetet tona për t'i ndihmuar këto biblioteka dhe cilat janë nevojat e tyre.

Nëse problemet janë të natyrës financiare, atëherë duhet bartur përgjegjësinë te institucionet prej nga pritet të japin këtë përkrahje, pra te institucionet e pushtetit qendror dhe të pushtetit lokal. Ndërsa ajo që është pjesë e përgjegjësisë së Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe bibliotekave ndërkomunale dhe komunale, është që të sigurohen informata nga përgjegjës të shkollave, bibliotekarë të këtyre shkollave, përdoruesit e bibliotekave (nxënës dhe mësimdhënës), me qëllim që të hulumtohen pastaj kapacitetet se sa objektivisht mund të jenë të realizueshme kërkesat - për të vënë së mbari punët për funksionimin e mirë të një biblioteke shkollore. Në këtë kontekst, Departamenti i Arsimimit Bibliotekar i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ka vizituar shumë biblioteka shkollore dhe ka siguruar shumë informata për gjendjen e tyre. Ndonjë bibliotekë qëndron mirë me hapësirat e bibliotekës, tjetra me fondet dhe përpunimin e tyre, ndonjë me nivelin e infrastrukturës e të rrjetit të kompjuterëve etj., por vështirë është të gjesh bibliotekë që i ka të plotësuar të gjitha kë kushte.

Duke reflektuar në gjithë këto çështje që kërkojnë zgjidhje, çdo takim që do të tubonte ekspertë të bibliotekarisë, komunitetin bibliotekar të bibliotekave të shkollave, si dhe drejtuesit e këtyre shkollave - nën monitorimin dhe pjesëmarrjen edhe të institucioneve qeveritare, do të mund të afronte mundësinë e ndërtimit të një platforme dhe strategjie për zhvillimin e bibliotekave të shkollave të Kosovës, që do të përkonte me:

- politikat e qarta të pasurimit të fondeve që janë në përputhje me kërkesat e përdoruesve - nxënësve dhe mësimdhënësve; hartim të politikave të përbashkëta për planifikim dhe zhvillim të koleksioneve shkollore, të cilat u vihen në ndihmë në procesin mësimor;
- përpunim, klasifikim dhe radhitje të koleksioneve në përputhje me standardet ndërkombëtare të bibliotekarisë;
- aftësim të personelit, që të mund t'i realizojë gjithë aktivitet që lidhen me bibliotekën në përputhje me këto rregulla dhe standarde ndërkombëtare;
- zhvillim të teknologjisë së informacionit, që u mundëson nxënësve dhe mësimdhënësve qasje në burimet elektronike; dhe
- buxhet të planifikuar për bibliotekat, në mënyrë që çdo vit shkollor biblioteka të jetë në gjendje të plotësojë nevojat e përdoruesve të saj.

BIBLIOTEKAT E SHKOLLËS DHE ROLI I TYRE NË NDIHMË TË PROCESIT MËSIMOR

AVDI LAKNA

Shërbimet e bibliotekës janë të rëndësishme për zhvillimin dhe avansimin e dijeve në një shoqëri që ka vizionin dhe vullnetin për të ngritur vlerat e veta në një nivel më të lartë. Një përfitim i rëndësishëm vjen nga shërbimi që ofrojnë bibliotekat shkollore, të cilat ofrojnë një pluralitet të njohurive në shumë fusha të dijes, duke nxitur leximin, arsimimin dhe kulturën te nxënësit në procesin e shkollimit.

Për këtë rol të rëndësishëm në edukim dhe arsimim, flet edhe Manifesti i Bibliotekave Shkollore, i hartuar nga UNESCO-s, në të cilin thuhet se bibliotekat shkollore sigurojnë informacione dhe ide që janë fundamentale për funksionimin e suksesshëm në shoqëri, të bazuar në informata dhe dije. Biblioteka shkollore pajis nxënësit me shkathtësi afatgjata të të mësuarit dhe zhvillon imagjinatën, duke iu mundësuar atyre të jetojnë si qytetarë të përgjegjshëm.

Në rrethanat tona është i nevojshëm të krijohen kushte në një bibliotekë shkollore, që siguron shërbime edukative, argëtuese dhe, madje, psikosociale. Shumë fëmijë dhe të rinj të Kosovës ende bartin pasoja nga stresi dhe ankthi për shkak të përjetimeve të rënda gjatë luftës së fundit në Kosovë. Programet e bibliotekave të shkollave duhet të përfshijnë iniciativa të ndryshme, për të krijuar dhe forcuar shprehitë e leximit te fëmijët dhe për të stimuluar imagjinatën dhe kreativitetin e tyre. Në këtë kontekst, është i nevojshëm zhvillimi i bibliotekave shkollore adekuate, ose i shërbimeve të tilla edhe nga bibliotekat komunale dhe bibliotekat speciale. Kjo mund të bëhet nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit mes stafit të shkollave dhe nxënësve, për t'i trajtuar qartë nevojat e përdoruesve të një biblioteke. Në këtë mënyrë, biblioteka shkollore do të siguronte gjithë koleksionin e duhur të librave dhe llojeve të tjera të materialeve bibliotekare në gjuhën e vendit dhe në gjuhë të huaja, që janë pjesë e planeve dhe programeve shkollore; kjo nënkupton edhe sigurimin e qasjes në internet, duke përfshirë këtu edhe përkrahjen e bibliotekarit për t'u dhënë ndihmën e vet përdoruesve në mënyrën e kërkimit në burime elektronike.

Bibliotekat shkollore duhet të kenë parasysh edhe pajisjen me koleksione të lodrave, për qëllime edukative, pikosociale dhe rekreative për fëmijët e nivelit parashkollor; ofrim të shfaqjeve teatrore apo muzikore, ekspozitave, shfaqje filmash ose rrëfime tregimesh etj.

Bibliotekat e shkollës bëjnë grumbullimin dhe sistematizimin e materialeve të shkruara dhe të pashkruara nga personeli i bibliotekës, i cili ndjek procedurat dhe proceset, ruan dhe jep në përdorim materialet për nevojat arsimore, jep informacione kulturore, si dhe këshilla për nevojat e arsimit të përgjithshëm dhe profesional.

Veprimtaria e bibliotekës shkollore është pjesë e sistemit arsimor, e përfshirë drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies dhe të aktiviteteve të drejtpërdrejta në edukim.

Biblioteka shkollore ka për detyrë të promovojë dhe përmirësojë të gjitha format e procesit arsimor; të krijojë kushtet për mësim; të ketë kapacitetet për t'u përshtatur me format e ndryshme të të mësuarit, duke plotësuar dhe pritjet e nxënësve dhe mësimdhënësve në procesin e të mësuarit; të ndihmojë nxënësit në të mësuar, duke nxitur frymën kërkimore dhe të vetëvlerësimit; të inkurajojë edukimin për respektim të vlerave demokratike; të zhvillojë, në veçanti, vetëdijen për vlerat e kulturës kombëtare, veçanërisht në lëndët e gjuhës dhe të letërsisë, por edhe të sistemit të vlerave multikulturore; të krijojë kushtet për një qasje interdisiplinare në mësimdhënie, duke inkurajuar një atmosferë të vullnetit dhe dëshirës për arsimim te nxënësit.

Që të jetë ky motivim në përputhje me qëllimet dhe objektivat e shkollës për arsimim, do të duhej një bashkëpunim i ngushtë mes bibliotekarit, nxënësit, mësimëdhënsit dhe udhëheqësit të shkollës, në mënyrë që biblioteka të përgatitet dhe të planifikojë të gjitha aktivitetet që përkojnë me planet dhe programet mësimore. Në këtë mënyrë, është e rëndësishme gjetja e mundësive për zhvillimin e shprehive të nxënësve për të vizituar bibliotekën, nëpërmjet frekuentimit të organizuar dhe sistematik të nxënësve në bibliotekë. Këtu vend të veçantë zë futja e metodave bashkëkohore në mësimdhënie, pasurimi i bibliotekës me koleksione formatesh dhe përmbjatjesh të ndryshme; udhëzime për mënyrën dhe metodat e hulumtimit të referencave (përdorimi i leksikonëve, enciklopedive, fjalorëve, etj.); organizimi i punës me nxënësit në grupe; zhvillimi i aktiviteteve garuese në procesin mësimor si dhe në kohën e lirë; dhënia e

udhëzimeve nxënësve në përgatitjen e një teme të caktuar, të një testi, të një shkrimi të esesë etj.; udhëzimi i nxënësve për hulumtime themelore dhe përdorim të burimeve të dijes (informatave); edukimi sistematik i nxënësit për mësim të pavarur dhe të mësuarit gjatë gjith jetës.

Bashkëpunimi me mësimdhënësin, nënkupton bashkëpunimin me mësimdhënës të të gjitha lëndëve mësimore, në mënyrë që biblioteka të jetë e pajisur me koleksione adekuate, meqë shkëmbimi i informacionit me mësimdhënës nuk tkurret vetëm në pjesën e teksteve lëndore dhe të lekurës shkollore, që është e lidhur me planet dhe programet shkollore, duke pasur parasyh se mësimdhënësit përdorin një sërë llojesh të literaturave shtesë, që janë pjesë e punës së tyre në grupe, në përgatitjen e orëve mësimore dhe punëtorive krijuese. Kjo nënkupton bashkëpunimin e mësimdhënësit me bibliotekarin edhe para zhvillimit të një ore mësimore dhe jo vetëm të një bashkëpunimi që lidhet me përgatitjen e planit vjetor, mujor apo javor.

Veprimtaria profesionale e Bibliotekës shkollore, përfshihet në një varg aktivitetesh, si: organizimi dhe menaxhimi i bibliotekës dhe sallave të leximit; pasurimi i bibliotekës me koleksione adekuate, që do të thotë një planifikim i kujdesshëm i pasurimit me materiale bibliotekare, që i përshtatet planit dhe programit të shkollës; klasifikimi dhe katalogimi i koleksioneve, që do të thotë se koleksionet në bibliotekën e shkollës mund të jenë të klasifikuara sipas KUD-it, apo ndarjes së koleksioneve sipas moshës, të kataloguara sipas rregullave dhe standardeve të ISBD-së, apo sipas standardit UNIMARC; monitorimi dhe evidentimi i fondeve të bibliotekës, që nënkupton përshkrimin e të dhënave mbi përdorimin e fondeve të bibliotekës; njoftimi sistematik i nxënësve, mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj; përpunimi i literaturës dhe informacioneve bibliografike për disa lëndë të veçanta mësimore, si bibliografi të përgjithëshme ose tematike të botimeve për fëmijë dhe nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, si një nga format më efikase, për dhënien e informacionit të plotë dhe të organizuar, për një përmbjatje apo periudhë të caktuar; përpunimi i literaturës për trashëgiminë kulturore, e cila promovon dhe siguron bazë për të kuptuarit e kulturave të ndryshme; ruajtja e koleksioneve të bibliotekës etj..



Bibliotekat shkollore duhet të kenë edhe fondin referal. Në këtë fond vendosen enciklopedi, almanakë, vjetarë, udhëzues të ndryshëm dhe materiale të tjera, nga të cilat mund të merret informacion i dobishëm shpejt dhe sakt nga përdoruesit – nxënësit dhe mësimdhënësit.

Gjithashtu, nga biblioteka shkollore hartohet programi i veprimtarive të bibliotekës, programi arsimor i shkollës, si dhe i enciklopedive të improvizuara për ngjarje dhe data të shënuara, që nënkupton lidhjen e nxënësve me data dhe ngjarje të rëndësishme kulturore dhe historike të një vendi apo më gjerë.

Në shërbim të afirmimit dhe propagandimit të librit dhe të dijes në shkollë, profesionalizmi, shërbimi i mirë, mirësjellja, përkushtimi, respekti dhe vullneti, do të duhej të karakterizonin stafin e një biblioteke shkollore, për të realizuar me sukses misionin arsimor dhe kulturore një bibliotekë shkollore - si një vatër dhe ambient joshës që bën për vete të gjithë nxënësit.

Referencat:

- Ligji për bibliotekat, 2003/6 URL: http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/2003_6_al.pdf;
- Organizimi i informacionit në bibliotekë / përg. Farfuri Xhaja; Tefta Buzo. Tiranë: Naim Frashëri, 2003;
- Shërbimi i bibliotekës publike: udhëzime të IFLA/UNESCO-s për zvillim / [IFLA]; përgatitur nga një grup pune drejtuar nga Philip Gill në emër të Seksionit të Bibliotekave Publike. Tiranë: Shoqata e Punonjëseve të Bibliotekave të Shqipërisë, 2002;
- IFLA. URL: http://www.ifla.org/

TRASHËGIMIA E KOSOVËS ËSHTË SHTËPIA JONË*

BERAT DAKAJ - ARMAGEDONI

Kosova është shtet i ri, por ka kulturë shumë të vjetër. Është shtet shumetnik, laik dhe mik. Është thënë, nga shumë etnologë e historianë ballkanikë, se ky vend është thesar i kulturës së Ballkanit, kurse se është e vendosur në tokën Dardane. Nëpër kohë të ndryshme, gjatë luftërave, është dëshmuar edhe si vend i paqes.

Sido që të ketë qenë e kaluara e saj dikur, e kushdo që të ketë jetuar nga të parët tanë këtu, sot, duke qenë shtet i tillë (shumetnik, laik e mik), brenda territorit shtetëror të vet ka kulturë, gjithashtu, shumetnike, të cilën përpiqet ta ruajë, me mish e me shpirt, edhe me pakicat (turqit, serbët, boshnjakët, romët, ashkalitë).

Por, problemi është që, sot Kosova në kohë paqe ka edhe pak shkëndija të luftës në trashëgiminë kulturore!

Në këtë bashkëjetesë shumetnike ajo sot ka disa probleme, të cilat herë sa vijnë e i shtohen, herë sa vijnë e i zvogëlohen! Krejt këto paradokse të dëmshme për trashëgiminë, kemi qenë dëshmitarë, se kanë ndodhur pas përfundimit të luftës (kujtojmë trazirat në mars të vitit 2004 në disa komuna të Kosovës). Një, për shkak të temperaturave politike të asokohshme ndërmjet Kosovës e Serbisë: e para, që bënte rrugë drejt formimit të shtetit të pavarur; e dyta, që protestonte e kërcënonte, kinse kjo është pjesë e vet, e Jugosllavisë, pa qenë e saj. Dy, për shkak të vetëdijes së ulët të opinionit për vlerën e trashëgimisë.

Por, pas të gjitha atyre kthesave të shpeshta e të kohëpaskohshme, erdhi një e mirë e përbashkët e, e përhershme, për të dyja vendet: Pas konflikteve fizike e diplomatike, Kosova u bë shtet, u nda nga ish-Jugosllavia. Formoi parlamentin dhe shkroi, me këshillat e miqve ndërkombëtarë, Kushtetutën. Ndërsa, Serbia, vazhdoi shtetësinë e britmën e vet për Kosovën, por pa të, deri edhe sot. Ndërkohë, në Kosovë u hapën e u mbyllën edhe shumë probleme të tjera. Aty-këtu, si jermë, përmendej edhe çështja e trashëgimisë së saj kulturore.

Por, problemi është që, sot një pjesë e madhe e trashëgimisë kulturore të Kosovës nuk nderohet!

Sot Kosova ka trashëgimi të vet ashtu si më parë, ka identitet evropian ashtu si më parë, simbole të reja si kurrë më parë (flamur e himn). Ndërsa, nderohet, si komb shqiptar. Ajo është, po qe se i duhet Serbisë, fqinje e mirë për të dhe për të gjithë fqinjët e tjerë në Ballkan.

Por, problemi është që, sot për trashëgiminë kulturore të Kosovës përkujdeset pak kush e i bën dëm shumëkush.

Kjo dashamirësi ndërmjet fqinjëve ruhet e i shtrin rrënjët e miqësisë, nëse brenda vendit tonë respektojmë e ruajmë - trashëgiminë e shtetit shumetnik - objektet materiale të shenjta të tij (shtëpitë e ZOTIT): kishat, xhamitë e manastirët; objektet si: muzetë, kullat, hamamet, urat, bibliotekat (Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, bibliotekat ndërkomunale); vlerat shpirtërore: këngën, vallëzimin; vlerat e punëdorës: veshjen, qëndisjen, drugdhendjen e gurgdhendjen e plot punë të tjera me interes për shkencat e për artet.

Më konkretisht, duhet të kihet përkujdesje më e madhe për: Muzeun Etnografik në Pejë, Muzeun Kombëtar të Kosovës, Muzeun Hekurudhor të Kosovës, Muzeun Etnologjik "Emin Gjiku" në Prishtinë, shtëpinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Muzeun Arkeologjik në Prizren, Muzeun në Mitrovicë, hamamet dhe kalatë e shumta të shndërruara në muze. Ka dhe shumë objekte të tjera me rëndësi të veçanta, por shqetësimet duhet dhënë së pari për këto.

Sigurisht se në të gjitha këto objekte ka pjesë të folklorit, në këtë kontekst, të popullit shqiptar, madje pjesë më të veçanta e më të paharrueshme të tij, të cilave u duhet përkujdesje e shtuar e mbrojtje e autorësisë nga njerëzit e ligj, edhe kur provokohen e përpiqen të përvetësohen ato sende nga dora e huaj pa qenë të saj!

Por, problemi është që, sot Kosova ka pak para për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe për promovimin e saj në Evropë dhe në Botë. Madje, ka pak

** Ky tekst është shpërblyer me çmimin e tretë në konkursin për artikullin më të mirë të shkruar e të botuar në vitin 2009 për trashëgiminë kulturore shpallur nga Fondacioni për Trashëgimi Kulturore pa Kufij CHwB. Dhjetor 2009*

njerëz të vet që dinë si t'i mbështesin projektet rreth saj.

Në Kosovë ka përfunduar lufta që dhjetë vjet, por edhe pas kësaj dekade zhvillohet një luftë e ftohtë në dhe për kulturën e saj. Ashtu si më parë, ende kultura e saj është në krizë. Ende s'i jepen para të bollshme nga institucioni kryesor i saj - Ministria e Kulturës, nuk mbrohet e as nuk mbulohet sa e si duhet as nga kjo ministri e as nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

E tillë është e gjendja trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ndërsa një pjese të saj çdo ditë vdekja i sillet përreth! Në ç'mënyrë?

Në disa komuna të Kosovës, në të cilat ende ka frikë se mos dikush dëmton trashëgiminë, ruhen objektet nga policët e Kosovës, të EULEX-it, madje edhe nga ushtarët e kontingjenteve të atyre shteteve të botës që janë të pranishme në Kosovë që nga pas lufta.

Ruhen shtëpitë e ZOTIT. Ruhen punët e njerëzve. Ruhen edhe njerëzit së bashku me to. Pra, pasi janë të rrezikuara, duhet të ruhen, njashtu sikurse pylltari pyllin, njashtu sikurse bariu delen, njashtu sikurse ushtari kufirin, njashtu sikurse njeriu sendin e vet.

Kështu që, sot trashëgimisë kulturore së Kosovës, para së gjithash, i duhen: roja e përbashkët dhe respekti, patjetër përkrahja materiale nga shteti e institucionet e saj, pse jo edhe nga ndonjë organizatë ose fondacion jofitimprurës (bëmirës) siç është "CHwB" - Fondacion për Trashëgimi Kulturore pa Kufij.

I duhet përkrahje edhe nga ndonjë qendër e madhe kulturore, siç është Centre Français de coopération "Jain Monnet", që brenda një viti zhvillon mbi 1 000 aktivitete në Evropë.

Zhvillon edhe në Maqedoni, qoftë duke përkrahur projektet e rinisë në trajnimin (aftësimin) e saj për sensibilizimin e opinionit të gjerë publik dhe për trashëgiminë kulturore e historike, por edhe për pasuritë natyrore të vendit. Po ashtu, është interesuar t'i japë hapësirë për gjetjen e potencialeve ekonomike për restaurimin e ndonjë objekti kulturor të dëmtuar.

Pasi ndihma e kësaj shoqate i duhet Kosovës domosdo, po kaq domosdoshmërisht Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës duhet t'i obligojë punonjësit e saj (zyrtarët) për të organizuar takime me përfaqësuesit e kësaj shoqate dhe ndonjë tjetër të këtij soji në Botë, sepse Kosova në këtë kohë ka shumë nevojë ta sjellë botën përreth vetës.

Pra, përkrahjet qëllimmira janë të mirëseardhura nga cilido fondacion apo shoqatë i cilido shtet. Megjithëse, tekembramja, edhe nëse nuk na mbështet askush, këtë detyrë, me vullnetin më të madh, duhet ta kryejë gjithkush, sidomos ne si popull, sepse po flitet për trashëgiminë e popullit tonë. Andaj, pasi është e jona, t'i ruajmë e t'i nderojmë ato që i kemi vlera të përbashkëta, bashkërisht. Të jemi më të pranishëm e më të lidhshëm me kulturën. Mundësisht të marrim ndonjë aksion për organizimin e seminareve, me qëllim të ringjalljes së zanateve të vjetra dhe të artizanateve që janë në zhdukje e sipër në komunat e qyteteve të Kosovës, por edhe prezantime të ndryshme për t`i bërë me dije publikut edhe ato pjesë të historisë e të etnologjisë sonë që janë harruar, janë duke u harruar e duke u shkatërruar, njëkohësisht. Se, përkujdesja ndaj trashëgimisë, sinqerisht, ia rrit vlerën shtetit, punës së njeriut dhe të Zotit.

Por, nga të gjitha këto të këqija, është edhe një e mirë: sot kemi shumë miq në Kosovë që pasurinë shtetërore tonën e konsiderojnë pasuri të shtëpisë së vet, që punojnë vazhdimisht dhe që premtojnë edhe më tutje ndihmë për ne.

Tekefundit, këta janë shpresa e fundit e vetëdijesimit të institucioneve dhe të shoqërisë sonë për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore këtu e kudo!

INTERNETI, RËNDËSIA DHE HISTORIA E TIJ

Kush ka qenë për pushime në det sigur isht ka parë kaltërsinë e qiellit mbi të, sigurisht ka parë edhe pafundësinë e detit, madje domosdo i ka parë edhe gjatësinë e gjerësinë e tij. I njëjtë me gjithë këtë hapësirë "të pakufishme" detare është interneti, i cili, ashtu si detet, lidh njerëzimin dhe kulturat e popujve

Në kulturën tonë, dhe përgjithësisht në atë botërore, në masë ta madhe ka ndikuar kultura mediale (gazeta më pak; interneti, televizioni, multimedia më shumë). Teoricienët e gazetarisë (studimeve të komunikimeve masive) sot bëjnë me dije se interneti është mediumi më publik për të përçuar çfarëdo mesazhi te njerëzit, qoftë sociologjik, kulturor, letrar, politik etj.. Këtë raport kaq të afërt me të, interneti e siguron nëpërmjet rrjetit (angl. network), i cili jep mundësi për kyçje publike të rrjeteve të ndërlidhura kompjuterike, që transmetojnë të dhëna (data të caktuara duke përdorur Internet Protokollin IP standard).

Interneti është rrjet i rrjeteve që përmban miliona pjesëza të vogla rrjetesh rajonale, akademike, të biznesit e qeveritare, të cilat në vete përmbajnë informata dhe shërbime të ndryshme, siç janë posta elektronike, format e kontaktit, transferuesit e skedave dhe dokumentet e tjera nga e gjithë bota.

Fillimet e internetit datojnë nga vitet '60 të shekullit të kaluar, kur ai filloi si përpjekje e ushtrisë amerikane për t'i lidhur me rrjet/networks, bazat e saj nëpër Amerikë. Më pas këtë filluan ta bëjnë universitetet, duke u lidhur me njëra-tjetrën, dhe më vonë universitetet shërbyen si ISP për studentët dhe profesorët, me qëllim që të bëhej një shkëmbim sa më i madh informacionesh, ashtu siç është sot.

Zanafilla e idesë për ndërtimin e rrjetit, që për ne është i njohur me emrin "internet". Rrjedh nga koha e Luftës së Ftohtë në vitet ´60. Si iniciatorë të një rrjeti të tillë janë qarqet ushtarake të ShBA-ve, të cilat sot nga disa prezantues në internet kritikohen për mbajtjen sekrete të internetit.

Që në fillim të viteve ´60, ushtarakët amerikanë mendonin se si t'i mbronin informatat e mbledhura edhe në rast të ndonjë sulmi atomik nga kundërshtarët. Si zgjidhje më e mirë e këtij problemi shihej një rrjet elektronik. Me këtë rrjet duhej që të dhënat e njëjta të regjistroheshin dhe të shpërndaheshin në kompjuterë që gjendeshin në largësi. Në rast ndryshimi apo futjes së të dhënave të reja, duhej që ndryshimet të beheshin në të gjithë kompjuterët e lidhur në atë rrjet. Secili nga kompjuterët e lidhur duhej të komunikonte në disa lidhje me kompjuterët e tjerë. Vetëm në këtë mënyrë ishte e mundur vazhdimësia e komunikimit në rast të shkatërrimit të ndonjërit nga kompjuterët, ose këputjes së ndonjë lidhjeje.

Sidoqoftë, në vitin 1964 Forcat Ajrore të ShBA-ve angazhojnë firmën RAND Corporation për ndërtimin e projektit të quajtur "Rrjeti i decentralizuar". Kjo firmë nuk u angazhua për atë që ne sot e njohim si paraardhës të internetit.

Për shkak të shumë vështirësive, ky projekt nuk u realizua, kurse vetë ideja për një "rrjet të decentralizuar", ku bartja e të dhënave do të bëhej në formë paketash, mbeti në kokat zhvilluese.

Qendra Shkencore Advance Research Projects Agency (ARPA), që nga viti 1958 shërbente për zhvillimin shkencor për ushtrinë amerikane, vendosi që më 1966 ta ndërlidhë rrjetin me llogaritësin ARPA. Me këtë rast ideja për "rrjetin e decentralizuar" u zhvillua edhe më tej dhe mori një formë paksa më të kuptueshme. Në vitin 1969, në rrjetin ARPA-Net ishin të lidhur katër llogaritës. Tri vjet më vonë në ARPA-Net ishin të lidhur 40 llogaritës. Duhet theksuar se edhe në këtë kohë ARPA-Net ishte një rrjet i mbyllur. Nga ky rrjet i mbyllur do të ndërtohej më vonë rrjeti i internetit. Numri i llogaritësve të lidhur në këtë rrjet rritej dita-ditës, llogaritësit e lidhur kishin sisteme të ndryshme operative. Llogaritës të fabrikantëve të ndryshme, unix, e më vonë edhe kompjuterët personalë filluan të lidhen në këtë rrjetë. Disa nga këta llogaritës kishin lidhje të drejtpërdrejtë ndërsa të tjerët lidheshin me ndihmën e telefonit dhe të modemit. Me këtë paraqitet nevoja e një protokollimi të ri të bartjes së të dhënave. Ky protokoll duhej të mos jetë i bazuar në sistemin operativ të kompjuterëve të lidhur dhe shpejtësinë e bartjes së informatave. Si rezultat i kësaj nevoje lindi protokolli TCP/IP, e me këtë u bë edhe e mundshme bartja e informatave në rrjetin ARPA-Net në mënyrë të standardizuar për të gjithë llogaritësit e lidhur në këtë rrjet.

Merita shkencore në ARPA-Net kanë edhe studentët, të cilët e zbuluan këtë rrjet në mënyrën e vet. Dëshirë e

tyre ishte një tablo informative ku bëhet këmbimi i informatave në mes tyre. Si rezultat i kësaj pune krijohet i ashtuquajturi "Usenet" (rrjeti i përdoruesve). Me këtë u vendos edhe një gur në ndërtimin e internetit.

Nevoja e dallimit të botës shkencore dhe asaj ushtarake të lidhur në ARPA-Net, për shkak të sekreteve ushtarake solli që në fillim të viteve '80 nga ARPA-Net të ndahet rrjeti ushtarak Mil-Net, ndërsa ARPA-Net mbeti në duar të shkencëtarëve. Në pjesën civile të këtij rrjeti në vitet ´80 bëhet katapultimi i numrit të kompjuterëve të lidhur në të. Shkaktar i rritjes së numrit të lidhjeve konsiderohet organizata amerikane National Science Foundation (NSF). Kjo organizatë arriti që të gjithë llogaritësit e qendrave të rëndësishme shkencore në ShBA t'i lidhë në këtë rrjet. Kështu, me këtë lidhje u bë e mundshme që nga rrjete të vogla të kyçen në rrjetin e madh dhe nga ai në ndonjë rrjet apo kompjuter tjetër. Me këtë edhe u krijua "rrjeti i rrjeteve", i cili më tej u identifikua me fjalën "internet". Me këtë edhe fjala ARPA-Net u largua nga kokat e njerëzve rreth viteve ´80. Në të njëjtën kohë, edhe në Evropë ndiqeshin zhvillimet në këtë drejtim. Mirëpo, ato ishin të bazuara në Normat ISO. Pasi që modeli amerikan TCP/IP nuk ishte normë e ISO-s, ata edhe nuk e pranonin atë.

Në vitin 1986, themelohet organizata RARE (Réseaux Associés pour la Recherche Européenne) me qëllim të koordinimit të iniciativave për krijimin e një sistemi të lidhjeve të kompjuterëve në nivelin evropian. RARE lansoi projektin evropian COSINE (Cooperation for an Open Systems Interconnection Networking in Europe) për këtë qëllim.

Iniciativa evropiane iu përkulë suksesit të TCP/IP-së në Amerikë dhe më në fund vendosen për të krijuar një rrjet multi-protokollar, që ndër të tjera e pranonte protokollin TCP/IP. Ky sistem i lidhjes u emërtua EuropaNet dhe në të u lidhen qendra të ndryshme shkencore të Evropës.

URL DHE WWW

Të gjithë i keni dëgjuar fjalët URL dhe WWW. Por, ç'do të thonë këto fjalë? URL - Uniform Resource Locators, s'është asgjë tjetër por vetëm adresë e një faqeje në internet që përmban informacionin e shkëmbyer standard të shprehur me Http:// (HyperText Transfer Protocol), që ju e shkruani në çdo adresë që doni ta shihni në Internet. Hypertext do të thotë një tekst i regjistruar në një formë elektronike me lidhje referative ndërmjet faqeve. Kuptojeni Internetin si një qytet të madh që ka shumë banesa, ca pallate, rrugë, trafik, shtëpi të bukura dhe të këqija, reklama nëpër rrugë dhe matrapazë që duan të të tundojnë të hysh në faqet e tyre dhe të shesin diçka, ka shtëpi prostitutash dhe reklama të fëlliqura, ka edhe xhami dhe kisha, teqe dhe sinagoga, tempuj budistësh dhe orgjish. Pra, shkurt, ka çdo gjë të mirë edhe të keqe, por e rëndësishme është të dish adresën, njësoj siç duhet të dish adresën e shtëpisë ku do të shkosh.

WWW (World Wide Web) është bota jonë virtuale, Rrjeti i Përgjithshëm Botëror.

Imagjinojeni një rrjetë merimange gjigante që vazhdon të thuret edhe në momentet kur ti je duke lexuar këtë. Merimanga e ka trupin në ShBA, kurse këmbët gjithandej nëpër botë.

FTP (File Transfer Protocol) është standardi i përçimit të skedarëve, kur programi skedar-përçues duhet të mbështesë dërgimin e skedarit në një server interneti.

ISP (Internet Service Provider) është serveri që mban faqet dhe na bën të mundur lidhjen me internetin nga shtëpia. Serveri është një kompjuter që bën të mundur lidhjen me internetin. Pra, është vetëm një mbështetës që vetë është i lidhur me një server tjetër, kurse edhe ai tjetri vetë me një tjetër.

Hosteri (pritësi) është server që mban faqen tënde në internet dhe që bën të mundur që edhe të tjerët ta shohin atë. Kuptojeni atë si një dyqan me qira, për të cilin duhet t'i paguani qiradhënësit.

XHTML (extended HyperText Markup Language) dhe XML (eXtensible Markup Language) janë standarde të reja për krijimin e faqeve, versione të reja të HTML.

Prapashtesa .com në adresë do të thotë commercial dhe është për faqet me qëllime dhe përmbajte tregtare, .org do të thotë organization, .edu do të thotë education dhe është për universitete dhe shkolla etj.

INTRANETI

Intraneti është një rrjet privat kompjuterësh me hyrje të kufizuar vetëm për një organizatë, por që përdor të njëjtat rrugë dhe forma pune që ka edhe Interneti. Faqja e internetit nënkupton të dhënat elektronike, te të cilat ka mundësi të qasjes përmes internetit publik dhe që janë të përcaktuara nga Kërkuesi Universal i Shënimeve (URL).

Përçimi i pateltë (ang. Wireless communication) apo komunikimi i pateltë është një emërtim që përdoret në informatikë për të treguar çdo lloj veprimi elektrik apo elektronik, i cili kryhet pa përdorimin e një lidhjeje me tel. Komunikimi i pateltë është përçimi i informacionit në largësi pa përdorimin e përcjellësve elektrikë apo me tela. Largësitë e përfshira mund të jenë të shkurtra (disa metra si p.sh. në një telekomandë televizori) apo shumë të gjata (mijëra apo madje miliona kilometra për radiokomunikim).

Përçimi i pateltë bën pjesë në degën e telekomunikacioneve. Ai përfshin telefonat celularë, ndihmuesit personalë digjitalë (NPD), dhe rrjetpunimin e pateltë. Shembuj të tjerë të teknologjisë së pateltë përfshijnë njësitë SGV, derëhapësit e garazheve, minjtë kompjuterikë të pateltë dhe tastaturat, televizionin satelitor dhe telefonat e pateltë. Në përgjithësi përçimi i pateltë përdor radiovalët, megjithatë përkufizimi shtrihet edhe në aparate më pak të përdorur, që shfrytëzojnë rrezatimin "infrarot" apo laserin.

Përgatiti: Shemsedin Morina

BKUK ORGANIZON

SEMINAR PËR BIBLIOTEKAT SHKOLLORE

Seminaristë në seminarin "Unifikimi i praktikave në bibliotekat shkollore të Kosovës"

15-16 dhjetor 2009, Prishtinë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës më 15-16 dhjetor 2009 organizoi seminarin me temën *"Unifikimi i praktikave në bibliotekat shkollore të Kosovës"*, në të cilin morën pjesë përfaqësues të bibliotekave shkollore të Republikës së Kosovës.

Në këtë seminar dyditor, u paraqiten kumtesa profesionale që kanë të bëjnë me bibliotekat shkollore, siç janë: format nxitëse të leximit, biblioteka e shkollës dhe roli i saj në ndihmë të procesit mësimor, pastaj përdorimi i kompjuterit në bibliotekë, burimet elektronike të informacionit etj.

Seminarin e hapi dr. Sali Bashota, Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ai foli për rëndësinë dhe ndihmën që mund të ofrojë informacioni dhe temat e një seminari të tillë në avancimin e shërbimeve të bibliotekave shkollore, të cilat kanë rol esencial në nxitjen për lexim, arsimim dhe kulturë te nxënësit në procesin e shkollimit.

Gjatë dy ditëve të seminarit me temën: *"Unifikimi i praktikave në bibliotekat shkollore të Kosovës"*, referuan bibliotekarë dhe udhëheqës të shërbimeve profesionale të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, për tema dhe probleme të ndryshme që i preokupojnë bibliotekat shkollore: Ramize Bajraktari: *"Unifikimi i praktikave në bibliotekat shkollore"*; Avdi Lakna: *"Biblioteka e shkollës dhe roli i saj në ndihmë të procesit mësimor"*; Ramush Zeka: *"Përdorimi i kompjuterit në bibliotekë dhe burimet elektronike të informacionit"*; Bedrije Mekolli: *"Sfidat e ruajtjes dhe konservimit të koleksioneve bibliotekare shkollore"*; Jetish Kadishani: *"Koleksioni i fotografisë dhe biblioteka"*; Zejnije Qerimi: *"Informatat bibliotekare: Katalogët, bibliografitë, fjalorët, enciklopeditë... etj"*; Zizë Kraja: *"Puna me lexues: Format nxitëse të leximit dhe ofrimi i shërbimeve bibliotekare"*; Muharrem Halili: *"Njohja me Manifestin e IFLA-s për bibliotekat shkollore"*; Lavdie Rrahmani: *"Zhvillimi i koleksioneve të bibliotekës: Llojet e materialeve dhe sistemimi i tyre në biblioteka"*; Bukurije Haliti: *"Katalogimi dhe klasifikimi i materialeve bibliotekare dhe formimi i katalogëve të bibliotekës"*.

Seminari kishte për qëllim unifikimin e menaxhimit dhe të praktikave në bibliotekat e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës, si dhe sensibilizimin e opinionit për rëndësinë që kanë bibliotekat shkollore në arsimin parauniversitar e më gjerë.

Ky është seminari i parë i këtij lloji që është organizuar për punonjësit e institucioneve shkollore nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Diana Topalli

BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E BIBLIOTEKARISË DHE TË KËRKIMEVE SHKENCORE MIDIS PRISHTINËS DHE ZAGREBIT

Zagreb (Kroaci) 8-11 dhjetor 2009

Në kuadër të bashkëpunimit midis dy institucioneve më të larta të bibliotekarisë, asaj të Kosovës dhe Kroacisë, nga 8-11 dhjetor 2009, drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës Prof.dr. Sali Bashota dhe dekani i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës Prof.dr. Osman Gashi, i bënë një vizitë zyrtare Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kroacisë në Zagreb dhe Fakultetit Filozofik të Universitetit të Zagrebit.

Në takimin me drejtorin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kroacisë - Prof. dr. Tihomil Mashtrovic, u bisedua për bashkëpunimin e mëtejmë mes institucioneve më të larta të bibliotekarisë të të dy shteteve, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis BKUK-së dhe BKU të Kroacisë, e cila është bërë më 7 tetor 2009 në Prishtinë. Gjithashtu, është biseduar për manifestime konkrete që kanë të bëjnë me fushën e bibliotekarisë, por edhe për aktivitete të ndryshme kulturore me karakter shkencor që do t'i bashkorganizojnë këto dy institucione.

Gjithsesi, e veçanta e kësaj vizite zyrtare ishte edhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Fakultetit Filozofik të Universitetit të Zagrebit, të udhëhequr nga dekani Prof. dr. Damir Boras dhe Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës të udhëhequr nga dekani Prof. dr. Osman Gashi.

Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Fakultetit Filozofik të Universitetit të Zagrebit dhe Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës përfshin disa pika konkrete në realizimin e projekteve të veçanta për një periudhë pesëvjeçare, siç janë: bashkëpunimi në fushën e kërkimeve shkencore, ligjëratave si dhe atë të simpoziumeve. Në këtë drejtim, shkëmbimi i hulumtuesve dhe shkencëtarëve, shkëmbimi i studentëve, si dhe ofrim i informatave, publikimeve në fusha të caktuara, pa dyshim, janë në interes të përbashkët të të dy palëve.

Dr. Osman Gashi, dr. Tihomil Mashtrovic dhe dr. Sali Bashota

BIBLIOTHECAE 9, REVISTË SHKENCORE-KULTURORE E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË, 2008



Në këtë numër të revistës, janë përmbledhur kumtimet e Edicionit të tretë të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, e cila është mbajtur nga 20-22 nëntor 2008 në Tiranë.

Kumtimet kanë në fokus temën:,,Biblioteka - urë mes dijes dhe publikut", ku lexuesi mund të marrë informacione për praktikat dhe vizionet e specialistëve nga Shqipëria dhe Kosova për rolin që luajnë bibliotekat në epokën digjitale - si urë lidhëse mes dijes dhe publikut.

Temat e trajtuara pasqyrojnë aspekte të ndryshme teorike dhe praktike të bibliotekarisë lidhur me shërbimin e referencave në ,,autostradën" informative, terminologjinë bibliotekare, nismat për bibliotekat digjitale, kërkimin e avancuar përmes internetit, marrëdhëniet përdorues-personel-shërbim, dukurinë e raporteve Bibliografi e librit shqip-përdorues të bibliotekës. Në fokus janë kumtesat që trajtojnë çështjen e rolit ndërmjetësues të bibliotekave midis dijes dhe publikut - përdoruesve të koleksioneve, sidomos në rrethana të reja kur bibliotekat gjenden para sfidave të transformimit nga bibliotekat tradicionale drejt bibliotekave moderne, dhe kur tashmë kemi një shkallë më të lart të avancimit të qasjes në informata, respektivisht ofrimit të formave më praktike të shërbimeve për përdorues.

Në këtë botim, bazuar në gjendjen konkrete të bibliotekave dhe në problemet që janë trajtuar, është përfshirë edhe rezoluta e dalë nga punimet e kësaj Konference - e rëndësishme për të përcaktuar fushën e bashkëpunimit në mes të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

BEDRI HYSA "TEMPULLI I LIBRIT" (BIBLIOTEKA NË KUJTESËN TIME), BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS, PRISHTINË 2009

Autori Bedri Hysa, në librin "Tempulli i librit" (Biblioteka në kujtesën time), shpalos një pjesë të kujtimeve të tij si ish-drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, duke përkujtuar zhvillimin dhe sfidat e kësaj Biblioteke në vite.

Libri përmban shumë fakte, duke dhënë, njëkohësisht edhe historikun e këtij institucioni të parë të Bibliotekarisë në Kosovë.

Nëpërmjet kronologjisë së ngjarjeve që kanë përcjellë zhvillimin e këtij institucioni, lexuesit i ofrohet mundësi të ketë një informacion më të plotë rreth etapave nëpër të cilat ka kaluar ky institucion i rëndësishëm i kulturës, dijes dhe librit në Kosovë.

Përveç dokumentaritetit, autori ka arritur të përmbushë edhe anën estetike të këtij libri, që është një refleksion emocional e poetik i autorit me bibliotekën. Kujtojmë në hyrje të librit vjershën përkushtim për bibliotekën me titull: Para tempullit tim, si dhe në përmbyllje - Himnin e Bibliotekës, i dhënë në partiturë, me tekst të këtij autori dhe me kompozim të kompozitori Akil Koci.

Një vlerë të veçantë zë edhe albumi i fotografive, si dhe faksimilet e shkrimeve të gazetave, në të cilat pasqyrohet puna dhe aktiviteti i këtij institucioni gjatë viteve kur ka udhëhequr ky autor Bibliotekën.

Izet ABDYLI